

KODI I SJELLJES KUNDËR KORRUPSIONIT PËR KOMUNITETIN E BIZNESIT

KODI I SJELLJES DHE UDHËZUESI PËR TË LUFTUAR
KORRUPSIONIN PËR KOMUNITETIN E BIZNESIT NË
SHQIPËRI



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri



European Bank
for Reconstruction and Development



SNA *Presidenza del Consiglio dei Ministri*
Scuola Nazionale dell'Amministrazione

KODI I SJELLJES
KUNDËR
KORRUPSIONIT PËR
KOMUNITETIN
E BIZNESIT

KODI I SJELLJES DHE UDHËZUESI PËR
TË LUFTUAR KORRUPSIONIN PËR
KOMUNITETIN E BIZNESIT NË SHQIPËRI

DEKLARATË PËRGJEGJËSIE:

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë studim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë detyrimisht ato të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Bashkëpunimit për Zhvillim Ndërkombëtar (IDC), Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), apo të Shkollës Italiane të Administratës Publike (SNA).

E drejta e autorit © Prezenca e OSBE-së në Shqipëri 2017

Autorët:

Daniele Del Bianco

Besmir Beja

Ky Kod i Sjelljes botohet në kuadër të projektit të Prezencës së OSBE-së “Mbështetje për Masat Kundër Korrupsionit në Shqipëri”, i cili ka për qëllim reduktimin e praktikave korruptive në Shqipëri. Projekti zbatohet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, me mbështetje të Qeverisë Italiane, BERZH-it dhe me kontribut në ekspertizë nga Shkolla Italiane e Administratës Publike.



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri



European Bank
for Reconstruction and Development



AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO
Ufficio di Tirana



SNA
Presidenza del Consiglio dei Ministri
Scuola Nazionale dell'Amministrazione

KODI I SJELLJES KUNDËR KORRUPSIONIT PËR KOMUNITETIN E BIZNESIT

KODI I SJELLJES DHE UDHËZUESI PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN PËR KOMUNITETIN E BIZNESIT NË SHQIPËRI

SHKURTIMET

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

BB – Banka Botërore

OECD – Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

UNODOC – Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin

PNUD – Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara

SELDI – Lidhshipi i Evropës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet

IDRA – Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi

Kodi – Kodi i Sjelljes

BkB – Biznesi kundrejt Biznesit

BkZP – Biznesi kundrejt zyrtarëve publikë

NMV – Ndërmarrjet e Mesme dhe të Vogla

UNCAC – Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit

KKK – Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit

LNC – Ligji i Nëpunësit Civil

INDEX

SHKURTIMET	3
INDEX	4
HYRJE	7
QËLLIMI I KODIT TË SJELLJES KUNDËR KORRUPSIONIT	9
KRIJIMI I KODIT TË SJELLJES KUNDËR KORRUPSIONIT	10
KODI I SJELLJES KUNDËR KORRUPSIONIT PËR KOMUNITETIN E BIZNESIT NË SHQIPËRI	13
KODI STANDARD I SJELLJES	13
KOMENTE TË PËRGJITHSHME	21
VLERËSIMI I RREZIKUT	22
LLOGARITJA E KOSTOVE TË KORRUPSIONIT NË BIZNES	26
16 PARIMET E KODIT TË SJELLJES KUNDËR KORRUPSIONIT	26
FAKTORËT E SUKSESIT	30
Rekomandime për biznesin	30
Rekomandime për komunitetin e biznesit	31
Rekomandime nga komuniteti i biznesit	31
PARIMI 1: GARANTIMI I ANGAZHIMIT TË BIZNESIT	33
NË PRAKTIKË	33
DISPOZITAT LIGJORE	33
NË BIZNESIN TUAJ	34
TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT	34
PARIMI 2: GARANTIMI I ZBATIMIT TË PLOTË	37
NË PRAKTIKË	37
NË BIZNESIN TUAJ	37
TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT	37
PARIMI 3: GARANTIMI I KUPTIMIT TË PLOTË	39
NË PRAKTIKË	39
NË BIZNESIN TUAJ	39
TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT	39
PARIMI 4: MASAT PARANDALUESE EFEKTIVE	40
NË PRAKTIKË	40
DISPOZITAT LIGJORE	40
NË BIZNESIN TUAJ	41
TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT	41
PARIMI 5: GARANTIMI I VEPRIMEVE DISIPLINORE EFEKTIVE	42
NË PRAKTIKË	42
DISPOZITAT LIGJORE	42
TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT	43
PARIMI 6: GARANTIMI I RREGULLIMIT EFEKTIV	44
TË PAGESAVE LEHTËSUESE	44

NË PRAKTIKË	44
DISPOZITAT LIGJORE	44
NË BIZNESIN TUAJ	44
TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT	44
PARIMI 7: GARANTIMI I RREGULLIMIT EFEKTIV TË KONTRIBUTEVE PËR BAMIRËSI DHE SPONSORIZIMEVE	45
NË PRAKTIKË	45
DISPOZITAT LIGJORE	45
NË BIZNESIN TUAJ	45
TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT	46
PARIMI 8: GARANTIMI I RREGULLIMIT EFEKTIV TË DHURATAVE, MIKPRITJES DHE SHPENZIMEVE	47
NË PRAKTIKË	47
DISPOZITAT LIGJORE	47
NË BIZNESIN TUAJ	47
TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT	48
PARIMI 9: GARANTIMI I RREGULLIMIT EFEKTIV TË KONTRIBUTEVE POLITIKE	49
NË PRAKTIKË	49
DISPOZITAT LIGJORE	49
NË BIZNESIN TUAJ	49
TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT	50
PARIMI 10: GARANTIMI I PARANDALIMIT EFIKAS TË KONFLIKTIT TË INTERESIT	51
NË PRAKTIKË	51
DISPOZITAT LIGJORE	51
NË BIZNESIN TUAJ	51
A ORGANIZON BIZNESI IM TRAJNIME PËR NDËRGJEGJËSIMIN E TË GJITHË AKSIONERËVE, ANËTARËVE TË BORDIT DHE PUNONJËSVE?	51
TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT	52
PARIMI 11: GARANTIMI I ZBATIMIT TË PLOTË NGA PARTNERËT E BIZNESIT DHE NDËRMJETËSIT	53
NË PRAKTIKË	53
DISPOZITAT LIGJORE	53
NË BIZNESIN TUAJ	54
TË UDHËHEQËSH DUKE DHËNË SHEMBULLIN TËND	54
PARIMI 12: GARANTIMI I MONITORIMIT EFIKAS TË FLUKSIT FINANCIAR	55
NË PRAKTIKË	55
DISPOZITAT LIGJORE	55
NË BIZNESIN TUAJ	56
TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT	56
PARIMI 13: GARANTIMI I INTEGRITETIT TË PUNONJËSVE	57

NË PRAKTIKË	57
DISPOZITAT LIGJORE	57
NË BIZNESIN TUAJ	57
TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT	58
PARIMI 14: GARANTIMI I AUDITEVE TË BRENDSHME/TË JASHTME	59
NË PRAKTIKË	59
DISPOZITAT LIGJORE	59
NË BIZNESIN TUAJ	59
TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT	60
PARIMI 15: GARANTIMI I RAPORTIMIT TË SHKELJEVE	61
NË PRAKTIKË	61
DISPOZITAT LIGJORE	61
NË BIZNESIN TUAJ	61
TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT	62
PARIMI 16: GARANTIMI I KOMUNIKIMIT EFIKAS	63
NË PRAKTIKË	63
NË BIZNESIN TUAJ	63
TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT	63
REFERENCAT	64
SHËNIME NË FUND TË FAQES	66

HYRJE

Në vija të përgjithshme, korrupsioni është dhënia apo marrja e diçkaje me qëllim përftimin e një trajtimi favorizues.

Në Shqipëri, korrupsioni dhe mitëmarrja në një nga pengesat më të mëdha të sektorit të biznesit (UNODC, 2013) dhe ndikojnë ecurinë e ekonomisë. "Korrupsioni dhe format e tjera të krimit janë pengesë e madhe ndaj sipërmarrjes private dhe kanë efekt negativ në investimet private.

Një përqindje e konsiderueshme e bizneseve u paguajnë rryshfet zyrtarëve publike në mënyrë të përsëritur gjatë gjithë vitit." (UNODC, 2013)

Për të zhvilluar masa të përshtatshme kundër korrupsionit në nivel kombëtar, siç mund të jenë kodet e posaçme të sjelljes për bizneset, është e rëndësishme të kuptohet roli që luan korrupsioni në mjedisin e biznesit në Shqipëri. Edhe pse korrupsioni mund të jete i vështirë për t'u matur, disa anketa të kryera nga Banka Botërore (WB & IFC, 2013), UNODC (UNODC, 2013), SELDI (SELDI, 2014), OSBE & IDRA (OSCE & IDRA, 2015) tregojnë se sa ndikon korrupsioni tek sektori i biznesit në Shqipëri.

Këto studime ofrojnë një panoramë të dobishme për klimën e biznesit në Shqipëri, duke u përqendruar tek korrupsioni:

Për perceptimin e korrupsionit



- Korrupsioni vlerësohet të jetë pengesa e dytë më e madhe për veprimtaritë e biznesit (UNODC, 2013);
- Sipas anketave të kryera nga UNODC (UNODC, 2013), ndër dhjetë shoqëri tregtare, mbi tetë prej tyre (85.1 përqind e të anketuarve) kishin pasur të paktën një kontakt informal të drejtpërdrejtë me një zyrtar publik ose nëpunës civil gjatë 12 muajve përpara vrojtimit;
- Veprimtaritë e shërbimit të ushqimit dhe

akomodimit si dhe transporti janë ndër sektorët e biznesit më të ndikuar nga korrupsioni. Gjithashtu, sektorë të tjerë të ndikuar janë ato ku është më e zakonshme të ndërveprohet me zyrtarë publikë, duke përfshirë punonjësit e policisë, punonjësit e doganave, punonjësit e tatimeve, dhe punonjësit bashkiakë. (UNODC, 2013)

- Edhe pse në Shqipëri niveli i ndërgjegjësimit për korrupsionin është i lartë, ryshfeti shpesh shihet si mjeti për të kryer punë apo për të përfituar trajtim më të mirë. (UNODC, 2013)

Për besimin e përgjithshëm dhe ndërveprimin me sektorin publik



- Krahasuar me krimet e tjera të zakonshme, numri i krimeve si mashtrimi nga palët e treta dhe mitëmarrja është më i lartë; megjithatë numri i raportimeve për këto krime është shumë më i ulët se për krimet e tjera të zakonshme. Kjo mospërputhje tregon mungesë besimi tek autoritetet dhe tek masat kundër korrupsionit në sektorin e biznesit. (UNODC, 2013)
- Përfaqësuesit e bizneseve deklarojnë që në afro 1 në 4 raste të ndërveprimit me zyrtarët publikë (duke pasur ndërmend të gjitha ndërveprimet e këtij lloji përgjatë një viti) ka të përfshirë pagesën e një ryshfeti. (OSCE & IDRA, 2015)
- Ryshfeti ndërmjet bizneseve (BkB) shihet gjithashtu si mënyrë për të përfituar përparësi të padrejtë ndaj bizneseve rivale. (UNODC, 2013)

Edhe pse rreth 2 nga 3 biznese të anketuara thonë që "Ryshfeti dhe Korrupsioni" përbëjnë kosto të pashmangshme për të bërë biznes në Shqipëri (OSCE & IDRA, 2015), vihet re që po rritet ndërgjegjësimi rreth korrupsionit dhe kostove të tij si për korrupsionin ndërmjet bizneseve ashtu edhe për korrupsionin nga

biznesi kundërt zyrtarëve publikë (BkZP). Në fakt, shumica e bizneseve në Shqipëri (86%) "preferojnë një sistem ku zyrtarët publikë të mos pranonin kurrë dhurata/ryshfete dhe të mos bënin asnjëherë ndere."(OSCE & IDRA, 2015)

Gjithashtu, gjatë viteve të fundit në Shqipëri ka pasur zhvillime të rëndësishme në lidhje me antikorrupsionin:

- Në vitin 2006, Shqipëria iu bashkua Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC)(UNODC, 2006);
- Në nëntor të vitit 2013, u krijua Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK) për të koordinuar, monitoruar dhe raportuar mbi zbatimin e politikave kundër korrupsionit, në nivel kombëtar dhe vendor;
- Në mars të vitit 2014, "korrupsioni" u bë pjesë e fushës së veprimit të ndryshimeve të ligjit "Për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit me anë të masave parandaluese kundër pasurisë", që njihet si ligji "Anti-Mafia" (Kuvendi, 2004);
- Në shkurt të vitit 2014, hyri në fuqi Ligji i ri për Nëpunësit Civil (LNC);
- Në shtator të vitit 2014, u miratua ligji i ri për të drejtën e informimit. (SELDI, 2014)

Përveç pasojave të drejtpërdrejta ligjore si pasojë e kryerjes së veprës penale të korrupsionit, përfshirja në praktika korruptive po shihet gjithnjë e më shumë si rrezik për reputacionin dhe pozicionin e bizneseve në komunitetin kombëtar dhe ndërkombëtar të biznesit. Prandaj, bizneset që hartojnë, zbatojnë dhe i binden politikave dhe praktikave të brendshme kundër korrupsionit, në të vërtetë marrin përsipër zbatimin e një plani afat mesëm dhe afatgjatë zhvillimi si rezultat i të cilit, shoqëritë përfitojnë qendrueshmëri financiare dhe reputacion më të mirë.

Mekanizmat vetërregullues dhe sistemi i kontrollit të përputhshmërisë ligjore duket sikur ka ngelur prapa

në Shqipëri; një gjë e tillë është më e dukshme tek bizneset mikro dhe të vogla. Gjithashtu, organizatat e bizneseve duket sikur i kanë ende të kufizuara aftësitë për të mobilizuar dhe përfaqësuar komunitetin e biznesit.

Prandaj, bizneset duhet ta shohin Kodine Sjelljes Kundër Korrupsionit si mundësi për të pozicionuar strategjitë e tyre të zhvillimit në një plan më të qëndrueshëm dhe etik. Miratimi dhe zbatimi i një Kodi sjellje kundër korrupsionit nga shoqëritë tregtare mund të shmangë humbjen e të ardhurave për shkak të korrupsionit, sjell një mbrojtje më të mirë nga presioni për t'u korruptuar, rrit reputacionin dhe pozicionin në treg të shoqërisë, si dhe rrit interesin e partnerëve të biznesit dhe të konsumatorëve për shoqërinë tregtare; me një fjalë, Kodi mund të shërbejë për të shndërruar një shoqëri tregtare në liderin e së ardhmes të komunitetit shqiptar të biznesit.

QËLLIMI I KODIT TË SJELLJES KUNDËR KORRUPSIONIT

Çdo ditë bizneset përballen me sfida të reja dhe të pa njohura më parë dhe për shkak të paaftësisë së tyre për t'u përshtatur nuk mund t'i përballojnë këto sfida. Si pjesë e komunitetit global të biznesit i cili zhvillohet vazhdimisht dhe në mënyrë të shpejtë, bizneseve i nevojitet të përshtaten për të qëndruar ndërmjet më të mirëve si dhe për të qenë konkurrues në tregjet ndërkombëtare dhe vendore.

Zbatimi i praktikave të konkurrencës së ndershme dhe përqaftimi i standardeve të larta etike po kthehen gjithnjë e më shumë në parime kyçe për çdo biznes. Angazhimi për zbatimin e Kodit të Sjelljes Kundër Korrupsionit ndihmon bizneset të jenë në të njëjtën linjë me praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe është tregues i mirë i vlerave dhe kulturës që bizneset duan të përqafojnë dhe zbatojnë.

Kodi i Sjelljes Kundër Korrupsionit është:



mjet i posaçëm për biznesin për të paraprirë dhe parandaluar korrupsionin.

Kodi i Sjelljes është dokument që hartohet nga biznesi për të paraprirë dhe parandaluar disa lloje sjelljeesh të cilat mund të rrezikojnë reputacionin e biznesit dhe aftësinë e tij për t'u zgjeruar. Nuk ka modele apo standarde zyrtare të Kodit të Sjelljes. Sidoqoftë, një Kod i suksesshëm Sjellje duhet të vërë në dukje parimet dhe vlerat e përqafuara nga biznesi dhe të përshkruajë sjelljen që duhet të kenë të gjithë aktorët që kanë të bëjnë me atë biznes.



udhëzues që siguron përputhshmëri dhe përshtatje të praktikave të brendshme dhe të jashtme me angazhimin e biznesit kundër korrupsionit.

Kodi i Sjelljes Kundër Korrupsionit nuk është një ligj apo rregullore e detyrueshme për t'u zbatuar, por është shumë i rëndësishëm për të mbrojtur si punonjësit ashtu edhe reputacionin e vetë biznesit. Prandaj, nuk është një dokument që qëndron më vete. Qëllimi i tij është të shpjegojë – në terma të thjeshtë dhe konkretë – detyrimet ligjore që i lindin çdo biznesi sipas legjislacionit ekzistues dhe dokumenteve të tjera në bazë të të cilave administrohen shoqëritë tregtare. Prandaj, Kodi i Sjelljes nuk zëvendëson dispozitat ekzistuese ligjore dhe nuk zgjeron apo kufizon fushën e tyre të veprimit, por siguron përputhshmërinë e plotë të biznesit me parimet etike dhe ligjet që rregullojnë luftën kundër korrupsionit. Megjithëse Kodi i Sjelljes ofron një sërë udhëzimesh në lidhje me standardet, integritetin dhe sjelljen e kërkuar nga pronarët e biznesit, administratorët dhe punonjësit, nuk mund të trajtojë çdo situatë të mundshme me të cilën mund të haset një shoqëri tregtare. Prandaj, Kodi i Sjelljes nuk mund të zëvendësojë përgjegjësitë personale të çdo individi, por ka për qëllim të shërbejë si udhëzues për shoqëritë tregtare që të kryejnë veprimet e tyre në përputhje me parimet më të mirat të etikës dhe

ligjet që kanë të bëjnë me antikorruptionin. Ky dokument mund të përdoret për dy qëllime: si një kuadër i përgjithshëm për shoqëritë tregtare që të zhvillojnë një Kod të Sjelljes Kundër Korrupsionit dhe si një udhëzues për të nxitur bizneset të evidentojnë se çfarë duhet përfshirë në Kodin e tyre apo çfarë duhet t'i shtohet standardeve të tyre ekzistuese.

KRIJIMI I KODIT TË SJELLJES KUNDËR KORRUPSIONIT

Kodi i Sjelljes Kundër Korrupsionit dhe udhëzuesi i tij rrjedhin gjerësisht prej praktikave më të mira ndërkombëtare dhe prej dokumenteve të tjera që janë përdorur si referencë, të cilat janë përshtatur me nevojat dhe kontekstin shqiptar.

Janë kryer intervista të hollësishme me aktorë si nga komuniteti i biznesit ashtu dhe nga sektori publik me qëllim përshtatje në parimeve ndërkombëtare me kontekstin shqiptar.

Ky dokument është diskutuar edhe me përfaqësues nga bizneset shqiptare, përfaqësues të shoqatave shqiptare të biznesit dhe atyre të huaja që veprojnë në Shqipëri dhe me përfaqësues të administratës publike.

Qëllimi i këtij dokumenti është që t'i ofrojë komunitetit shqiptar të biznesit një mjet reference dhe udhëzues që të trajtojnë praktikën kundër korrupsionit në përputhje me parimet më të mira ndërkombëtare.

Lexuesi mund të marrë informacione të mëtejshme duke lexuar dokumentet e mëposhtme të cilët janë përdorur.

Parimet e Biznesit për Luftën ndaj Mitëmarrjes. Botimi për NVM-të nga Transparency International (2008)



Parime të Biznesit për Luftën ndaj Mitëmarrjes– botimi për NVM-të ("ndërmarrjet e vogla dhe të mesme"), është një instrument kundër korrupsionit në ndihmë të

ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që duhet të zbatojnë politikat e tyre kundër korrupsionit. Mund të përdoret si udhëzues për të kaluar pengesat që hasen nga NVM-të në zbatimin e kërkesave ndërkombëtare.



Udhëzimet e OECD-së për Ndërmarrjet (2011)

Udhëzimet e OECD-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe përbëjnë një nga dokumentet më të rëndësishme në nivel ndërkombëtar.

Nëpërmjet zbatimit të këtyre rekomandimeve, qeveritë ofrojnë një mjet reference jo të detyrueshëm për ndërmarrjet shumëkombëshe, për t'u ofruar atyre parime të përgjegjshme të sjelljes së biznesit.



Rregullat e ICC-së për Luftën ndaj Korrupsionit nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (2011)

Rregullat e ICC-së për Luftën ndaj Korrupsionit janë hartuar për të ndihmuar shoqëritë tregtare

të përshtaten me kuadrin ndërkombëtar kundër korrupsionit. Ato mund të përdoren nga ndërmarrjet si bazë për vetërregullimin, për të parandaluar korrupsionin dhe për të shmangur përpjekjet për zhvatje apo kërkesën e rryshfeteve



Klauzola Antikorrupsion e ICC-së nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (2012)

Klauzola Antikorrupsion e ICC-së është përgatitur me qëllimin për të ndihmuar shoqëritë tregtare të

luftojnë korrupsionin BkB. Ajo mund të përfshihet në çdo kontratë tregtare ndërmjet palëve, ku secila palë zotohet të zbatojë rregullat kundër korrupsionit. Klauzola është bërë pjesë e Kodit të Sjelljes dhe udhëzuesit me pëlqim të ICC-së.



Manuali Kundër Korrupsionit dhe i Përputhshmërisë për Bizneset nga OECD-ja – UNODC– Banka Botërore (2013)

Manuali Kundër Korrupsionit dhe i Përputhshmërisë për Bizneset është hartuar nga OECD-ja, UNODC dhe Banka Botërore në vitin 2013, me qëllim përdorimin e mjeteve për të luftuar në nivel ndërkombëtar korrupsionin në sektorin e biznesit. Manuali shërben si udhëzues jo i detyrueshëm për shoqëritë që kërkojnë instrumente praktike për të parandaluar dhe shkurajuar sjelljet e papërshtatshme. Prandaj, pjesa e parë ndihmon për gjetjen e kuadrit ndërkombëtar që rregullon luftën kundër korrupsionit në sektorin e biznesit; pjesa e dytë shpjegon se si të vlerësohen rreziqet brenda sektorit të biznesit; dhe pjesa e fundit përmban udhëzime praktike për hartimin e një kodi të efektshëm kundër korrupsionit, në bazë të një analize krahasuese të praktikave më të mira të vëna në zbatim nga shoqëritë tregtare.



Parimet e Biznesit për Luftën ndaj Mitëmarrjes nga Transparency International (2013)

Parimet e Biznesit për Luftën ndaj Mitëmarrjes, hartuar nga Transparency International në vitin 2013, kanë për qëllim të ofrojnë këshilla për shoqëritë që duhet të përmirësojnë politikën e tyre kundër korrupsionit, sipas praktikave të reja ndërkombëtare. Varianti i parë u botua në vitin 2003; varianti i rishikuar përqendrohet tek nevoja për të vlerësuar rrezikun përpara se të zhvillohen masa të efektshme për të luftuar mitëmarrjen.



Udhëzimet e OECD-së për Drejtimin e Ndërmarrjeve Shtetërore nga OECD-ja (2015)

Udhëzimet e OECD-së për Drejtimin e Ndërmarrjeve Shtetërore u hartuan

për herë të parë në vitin 2005, dhe u përditësuan në vitin 2015. Ato kanë për qëllim të shërbejnë si udhëzues për qeveritë, detyra e të cilave është të lejojnë Ndërmarrjet Shtetërore të operojnë në mënyrë efikase, sipas standardeve ndërkombëtare të llogaridhënies dhe transparencës. Qëllimi i këtyre rekomandimeve është të rregullojnë pronësinë pasive të qeverive si dhe ndërhyrjet e tepërta shtetërore.



Udhëzues për Matjen e Korrupsionit dhe Antikorrupsionit nga PNUD-i (2015)

Udhëzuesi për Matjen e Korrupsionit dhe Antikorrupsionit ka për qëllim të prezantojë mjetet që mund të përdoren për vlerësimin e ndikimit të politikave dhe programeve me qëllim që të matet përshtatshmëria e veprimeve kundër korrupsionit. Ai i drejtohet praktikuesve për t'u dhënë atyre indikatorë matës dhe modele për të luftuar rryshfetin dhe korrupsionin.



Broshurë për Etikën në Biznes nga Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (2016)

Broshura për Etikën në Biznes është hartuar nga Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri dhe ka për qëllim të ndihmojë shoqëritë të ndërtojnë një kod etike të përshtatur sipas kontekstit Shqiptar, duke u përqendruar edhe në praktikën kundër korrupsionit. Broshura është përgatitur duke u bazuar në kodet e sjelles së shoqërive tregtare që veprojnë në Shqipëri dhe duke u bazuar edhe në elementët kyç të ofruara nga organizata ndërkombëtare që veprojnë në sektorin e etikës së biznesit.

KODI I SJELLJES KUNDËR KORRUPSIONIT PËR KOMUNITETIN E BIZNESIT NË SHQIPËRI

KODI STANDARD I SJELLJES

PARATHËNIE

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në kuadër të qëllimit të saj për mjedis biznesi të drejtë, transparent dhe të ndershëm;

E ndërgjegjshme për rëndësinë e krijimit dhe përkrahjes së një mjedisi biznesi ndërkombëtar të shëndetshëm duke luftuar mitëmarrjen dhe korrupsionin;

Duke theksuar që korrupsioni përfaqëson një nga pengesat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe është një kërcënim për mjedisin e tregut;

Duke njohur pasojat negative të korrupsionit për zhvillimin e komunitetit të biznesit, shoqërive tregtare dhe punonjësve;

Duke ditur se lufta kundër korrupsionit është e mundur vetëm nëpërmjet angazhimit dhe sinergjisë ndërmjet sektorëve privatë dhe publikë si dhe me komunitetin ndërkombëtar;

Duke pasur parasysh të gjitha ligjet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar që rregullojnë sjelljen

e biznesit dhe masat për parandalimin e korrupsionit;

Ka zhvilluar si më poshtë Kodin e Sjelljes Kundër Korrupsionit për Komunitetin e Biznesit në Shqipëri:

Neni 1

Angazhimi i biznesit

1. Shoqëria është e angazhuar të mos përfshihet në asnjë veprim apo praktikë që mund të përbëjë mitëmarrje dhe korrupsion aktiv ose pasiv, qoftë me zyrtarë publikë apo me aktorë në sektorin privat. Gjithashtu, shoqëria angazhohet të respektojë të gjitha ligjet dhe të përkrahë praktikën më të mira kundër mitëmarrjes dhe korrupsionit në mjedisin shqiptar të biznesit.

2. Aksionerët/aksioneri i vetëm, anëtarët e Këshillit, Administratori, dhe drejtorë të lartë të shoqërisë angazhohen të zbatojnë vlerat themelore të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies, me qëllim respektimin e praktikave të mira tregtare ndërmjet bizneseve dhe në marrëdhëniet

kontraktuale ndërmjet biznesit dhe shtetit.

3. Asnjë objektiv biznesi nuk është më i rëndësishëm se kryerja e veprimtarisë tregtare nga shoqëria në përputhje me ligjet dhe praktikën e mira tregtare. Ky angazhim përforcon reputacionin e mirë të shoqërisë. Prandaj, për arritjen e objektivave të biznesit, shoqëria gjithmonë zbaton, respekton dhe përkrah standardet më të larta të integritetit dhe etikës së biznesit dhe siguron që veprimet e administratorëve, drejtorëve dhe punonjësve të tjerë të shoqërisë të jenë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregullat e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë dhe me standardet ndërkombëtare.

4. Asnjë administrator, drejtor apo punonjës i shoqërisë nuk gëzon autoritetin të kërkojë kryerjen e ndonjë veprimi apo mosveprimi që bën të paefektshëm këtë Kod të Sjelljes apo dispozitat e tij. Zbatimi i Kodit të Sjelljes nuk kufizohet ose kushtëzohet për shkak të praktikave të padrejta të konkurrencës në tregun Shqiptar ose nevojave tregtare, zakoneve të industrisë dhe nevojave të tjera.

5. Çdo punonjës, pavarësisht pozicionit të tij, ka për detyrë të shpërndajë dhe të vendosë në dispozicion këtë Kod të Sjelljes për punonjësit e tjerë dhe ekipin e tij. Çdo punonjës që shkel këtë Kod të Sjelljes, autorizon, apo për shkak të pa kujdesisë lejon punonjës të tjerë nën mbikëqyrjen e tij ta

shkelin atë, mban përgjegjësi disiplinore, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shoqërisë për burimet njerëzore.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Kodi i Sjelljes zbatohet për të gjithë aksionerët, administratorët, drejtorët e lartë dhe punonjësit e shoqërisë dhe për çdo degë apo shoqëri të kontrolluar prej saj.

2. Kodi zbatohet për çdo transaksion biznesi ku shoqëria merr pjesë, pavarësisht nëse transaksioni kryhet nga vetë shoqëria apo kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë nga palët e treta/ndërmjetësit. Ai zbatohet për transaksionet e biznesit të shoqërisë me palë të treta, si të sektorit publik dhe atij të sektorit privat, duke përfshirë dhe shitësit, furnitorët, përfaqësuesit, kontraktorët, nënkontraktorët dhe agjentët që veprojnë në emër dhe për llogari të shoqërisë.

Neni 3

Përkufizime

1. Në këtë Kod Sjellje termit e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1.1. **Korrupsion** do të thotë shpërdorimi i detyrës së besuar me qëllim marrjen e përfitimeve të parregullta për vete ose për persona të tjerë.

1.2. **Mitëmarria/Ryshfeti** është propozimi, premtimi, dhënia, autorizimi apo pranimi i çdo lloji përfitimi të parregullt nga apo për (a) një zyrtar publik

në nivel ndërkombëtar, kombëtar apo vendor; (b) një parti politike, zyrtar partie apo kandidat për një post politik; dhe (c) një administrator, drejtor apo punonjës i një shoqërie tregtare, qofshin këto praktika të kryera në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, apo me anë të palëve të treta, apo për këdo tjetër me qëllim marrjen apo ruajtjen e çdo lloj përfitimi të parregullt. Mitëmarrja shpesh përfshin (i) kthimin e një pjese të pagesës së kontratës tek zyrtarët publik ose të partive politike apo tek punonjësit e palës tjetër kontraktuese, të afërmit e tyre, miqtë apo partnerët e biznesit ose (ii) përdorimin e ndërmjetësve, si për shembull agjentëve, nënkontraktorëve, konsulentëve apo palëve të tjera të treta për të kanalizuar pagesa për zyrtarë publik apo të partive politike ose për punonjës të palës tjetër kontraktuese, të afërmit e tyre, miqve apo partnerëve të biznesit.

- 1.3. **Korrupsioni aktiv në sektorin privat** nënkupton premtimin, propozimin ose dhënien, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, për një person që ushtron funksione drejtuese në një shoqëri tregtare apo që punon në çdo pozicion në sektorin privat, të çdo përfitimi të parregullt për të apo për

një person të tretë, për të kryer ose moskryer një veprim në kundërshtim me detyrën ose funksionin e tij.

- 1.4. **Korrupsioni pasiv në sektorin privat** nënkupton kërkimin a marrjen, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, e çdo lloj përfitimi të parregullt, për vete apo për persona të tjerë, ose pranimin e një oferte apo premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksion drejtues apo që punon në çfarëdo pozicioni në sektorin privat, me qëllim për të vepruar apo për të mos vepruar në kundërshtim me detyrën ose funksionin e tij. **Korrupsioni aktiv i zyrtarëve publikë** nënkupton premtimin, propozimin ose dhënien, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, personit që ushtron funksionin publik, të çdo përfitimi të parregullt për të apo për një person të tretë, për të kryer ose moskryer një veprim, që lidhet me funksionin apo detyrën e tij.

- 1.5. **Korrupsioni pasiv nga zyrtarët publikë** nënkupton kërkimin apo marrjen, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, nga një person që ushtron funksione publike, të çdo përfitimi të parregullt apo të një premtimi të tillë, për vetë personin ose për një person të tretë, ose pranimin e një oferte apo premtimi që rrjedh nga një përfitim i parregullt, për të kryer ose

moskryer një veprim, që lidhet me funksionin apo detyrën e tij.

1.6. **Pagesat lehtësuese**, që njihen edhe si pagesa 'lehtësimi', 'shpejtimi' ose 'grasatimi', janë pagesa të vogla që kryhen për të siguruar apo përshpejtuar kryerjen e veprimeve rutinë që janë pjesë e detyrës funksionale të zyrtarëve publik.

1.7. **Konflikti i interesit** është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës dhe interesave privatë të një punonjësi të shoqërisë, në të cilën ai ka interesa privatë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij.

1.8. **Konflikt në dukje i interesit** është gjendja në të cilën interesat privatë të punonjësit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të parregullt të detyrave apo përgjegjësisë të tij, por që në fakt ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë.

1.9. **Konflikt i mundshëm i interesit** është gjendja në të cilën interesat privatë të punonjësit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit,

nëse punonjësi do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara.

1.10. **Person i lidhur** është çdo person i cili ka marrëdhënie personale apo financiare me punonjësit e shoqërisë, apo çdo person marrëdhëniet e të cilit me punonjësit e shoqërisë janë të tilla që, në mënyrë të arsyeshme, mund të ndikojnë në vendimmarrjen e punonjësve në kundërshtim me interesat e shoqërisë. Personat në vijim prezumohen të jenë persona të lidhur: (a) bashkëshorti/ja, ose/ dhe prindërit, vëllezërit apo motrat e bashkëshortit/es (b) fëmija, prindi, vëllai, motra apo bashkëshorti/ja e personave të mësipërm (c) të paralindurit ose të paslindurit, të afërmit në vijë të tërthortë të shkallës së dytë, birësuesi ose i birësuari, i afërm i shkallës së parë i bashkëshortit ose i bashkëshortes; dhe (d) personi që banon me punonjësin.

1.11. **Lobimi** përfshin çdo veprimtari që kryhet me qëllim që të ndikojë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi në formulimin ose zbatimin e politikave dhe proceseve vendimmarrëse të institucioneve qendrore dhe vendore, pavarësisht kanalit apo mjetit të komunikimit.

1.12. **Zyrtar publik** do të thotë çdo person që kryen detyra dhe ushtron funksione publike.

1.13. **Sinjalizues** është individ,

i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose që ka punuar më parë me shoqërinë, pavarësisht nga natyra e punës ose kohëzgjatja e saj, si dhe nëse paguhet apo jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni dhe në mirëbesim e raporton tek personi i autorizuar ose tek Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit ("ILDKPKI") në përputhje me ligjin 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"

1.14. Vlerësimi i rrezikut kundër korrupsionit

përfshin shumëllojshmërinë e mekanizmave që përdor shoqëria për të vlerësuar gjatat që të shfaqen forma të veçanta të korrupsionit brenda shoqërisë dhe në ndërveprimet me jashtë si dhe efektet që mund të ketë ky lloj korrupsioni.

1.15. Pagesa e haraçit nënkupton kthimin e një pjese të shumës monetare të marrë, veçanërisht si rezultat i shtrëngimit apo i një marrëveshjeje të fshehtë. Pagesat e haraçit janë rryshfete që paguhet pas fitimit të kontratës. Ata ndodhin në departamente që merren me blerjen, kontraktimin, apo me vendimin për dhënien e kontratave. Furnitori ofron rryshfetin duke paguar si haraç një pjesë të vlerës së

kontratës tek blerësi (apo tek punonjësi i blerësit), qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo me anë të një ndërmjetësi.

1.16. Dhurim ose donacion

është ofrimi i fondeve ose i bazës materiale përmes një kontrate ose marrëveshjeje për të mbështetur realizimin e qëllimeve të një organizate jofitimprurëse.

1.17. Sponsorizim do të thotë ofrim mbështetjeje financiare dhe materiale për veprimtari sociale dhe publike.

1.18. Kontributet politike do të thotë

(A) çdo dhuratë, abonim, hua, parapagim apo depozitim parash apo sendesh me vlerë i cili kryhet për qëllime politike; (B) përfshin pagesën nga ana e çdo personi, përveç kandidatëve, partive politike apo organizatave të lidhura me to, të çdo shume për kompensimin e shërbimeve të një personi tjetër, të cilat personi ia jep një kandidati apo partie politike pa kundërshpërblim për përmbushjen e qëllimeve politike të kandidatit apo partisë politike; dhe (C) përfshin dhënien e shërbimeve personale për përmbushjen e çdo qëllimi politik.

1.19. Palë e tretë me të drejta përfaqësimi

përfshin çdo shoqëri të kontrolluar, shoqëritë e përbashkët, agjent, përfaqësues, konsulent, lobist, komisioner, agjenci

marketingu, avokat, furnitor apo çdo palë tjetër të tretë e cila është nën kontrollin e shoqërisë.

Neni 4

Masat për luftën kundër korrupsionit

1. Ky kod i sjelljes është pasqyrim i angazhimit dhe i programit të shoqërisë për parandalimin e korrupsionit dhe mitëmarrjes në të gjitha veprimtaritë nën kontrollin e saj.

2. Programi i shoqërisë për parandalimin e korrupsionit përfshin rregullat dhe procedurat e mëposhtme:

2.1. Kuadri organizativ – kuadri organizativ i shoqërisë përcakton rolet dhe përgjegjësitë që i caktohen secilit funksion dhe bazohen në parimin e ndarjes së funksioneve.

2.2. Rregullorja e brendshme – shoqëria ka rregullore të brendshme që rregullon veprimtaritë që kryhen nga secila strukturë e shoqërisë.

2.3. Rregullat dhe procedurat për kontrollin e administrimit dhe auditimin e shoqërisë.

2.4. Rregullat dhe procedurat për burimet njerëzore (të cilat duhet të përfshijnë edhe rregullat për rekrutimin, trajnimin dhe masat disiplinore).

2.5. Rregullat dhe procedurat për prokurimin.

2.6. Rregullat dhe procedurat për

parandalimin e konfliktit të interesit.

2.7. Rregullat dhe procedurat për menaxhimin e rrezikut.

2.8. Rregullat dhe procedurat për komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm.

2.9. Rregullat dhe procedurat për shpenzimet e mikpritjes.

2.10. Rregullat dhe procedurat për kryerjen e vlerësimit të partnerëve të biznesit, agjentëve dhe ndërmjetësve.

3. Shoqëria angazhohet të përditësojë masat për luftën ndaj mitëmarrjes dhe korrupsionit në bazë të vlerësimit të vazhdueshëm të rrezikut. Shoqëria kryen vlerësimin e rrezikut të korrupsionit në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe në konsultim me punonjësit, sindikatat dhe organet e tjera përfaqësuese të punonjësve dhe aktorët e tjerë të rëndësishëm. Për këtë qëllim, në përputhje me rregullat dhe procedurat për vlerësimin e rrezikut, zyrtari përgjegjës është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e procedurave për vlerësimin e rrezikut të korrupsionit.

4. Administratori është përgjegjës të mbikëqyrë që Programi të zbatohet në mënyrë të efektshme dhe i raporton Bordit të Drejtorëve /Bordit Mbikëqyrës/ Mbledhjes së Aksionerëve çdo 6 muaj për përshtatshmërinë dhe efektshmërinë e programit.

5. Të gjithë administratorët dhe drejtorët e lartë të shoqërisë dhe çdo punonjës që ka pozicion nga

ku mund të ndikojë rezultatet e biznesit ka detyrë të deklarojë çdo vit, me shkrim, që (a) ka lexuar kodin e sjelljes, (b) ka vepruar në përputhje me programin e shoqërisë për të parandaluar korrupsionin dhe mitëmarrjen, dhe (c) ka komunikuar [zyrtarit të caktuar të shoqërisë, përgjegjës për çështjet e integritetit dhe përputhshmërisë] çdo informacion që mund të ketë në lidhje me ndonjë shkelje të mundshme të Programit nga punonjës të tjerë të shoqërisë ose nga partnerë biznesi dhe ndërmjetës.

Neni 5

Politika me tolerancë zero ndaj korrupsionit

1. Korrupsioni në sektorin publik ose privat përbën vepër penale dhe ndëshkohet me burg në përputhje me Kodin Penal Shqiptar. Shoqëria ka tolerancë zero ndaj çdo forme të mitëmarrjes dhe korrupsionit.
2. Shoqëria nuk lejon premtimin, propozimin ose dhënien e asnjë përfitimi të parregullt për Zyrtarët Publikë, klientët, furnitorët dhe të çdo pale tjetër të tretë.
3. Aksionerët, Administratorët, drejtorët e lartë, punonjësit dhe agjentët/ndërmjetësit ose çdo palë e tretë të cilët mund të veprojnë në emër dhe për llogari të shoqërisë, nuk lejohen, drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, të premtojnë, propozojnë, japin apo autorizojnë çdo lloj përfitimi të parregullt apo të paligjshëm për ndonjë Zyrtar Publik apo për ndonjë individ apo organizatë

tjetër, me qëllim ushtrimin e ndikimit të parregullt tek marrësi, për të kryer ose moskryer një veprim në kundërshtim me detyrën a funksionin e tij, për të siguruar avantazhe të parregullta për shoqërinë ose për të shpërblyer dikë në mënyrë të parregullt për veprime të mëparshme të tij.

4. Shoqëria gjithashtu ndalon kërkimin a marrjen apo pranimin e ryshfetit, pagesës së haraçit, pagesën me qëllim ushtrimin e ndikimit të paligjshëm apo çdo lloj nxitjeje, përfitimi ose avantazhi tjetër të parregullt.

5. Ndalimet e mësipërme duhet të interpretohen në kuptimin më të gjerë të mundshëm.

Neni 6

Pagesa lehtësuese

1. Shoqëria ka ndaluar çdo lloj forme korrupsioni. Shoqëria është e ndërgjegjshme që refuzimi për të bërë një pagesë lehtësuese mund të çojë në vonesa tregtare, për shembull, në dhënien e lejeve/licencave/autorizimeve qeveritare dhe që mund të shkaktohen humbje të ardhurash për shoqërinë për shkak të këtij qëndrimi të fortë ndaj çdo forme korrupsioni. Pavarësisht kësaj, shoqëria, punonjësit e saj dhe agjentët/ndërmjetësit/palët e treta që kanë të drejtë të veprojnë në emër dhe për llogari të shoqërisë, nuk duhet të kryejnë pagesa lehtësuese, edhe nëse çmohet që një pagesë e tillë do të ishte në interes të shoqërisë në

planin afatshkurtër.

2. Nëse punonjësve dhe agjentëve/ndërmjetësve që kanë të drejtë të veprojnë në emër dhe për llogari të shoqërisë i kërkohet, drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, të bëjnë një pagesë lehtësuese, ose nëse ata çmojnë që ndodhen në një situatë ku ka shumë gjasa që t'i kërkohet një gjë e tillë, ata duhet t'ua raportojnë këtë situatë menjëherë drejtorit të tyre.

3. Më pas, drejtorët kujdesen që Administratori të njoftohet me shkrim jo më vonë se tre ditë nga data e marrjes së raportimit. Administratori bashkëpunon me organizata biznesi dhe autoritetet përkatëse shtetërore për të zgjidhur problemin në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Donacionet dhe sponsorizimet

1. Shoqëria mund të kryejë dhurime/donacione dhe sponsorizime për organet shtetërore ose për zyrtarët publikë, apo palët e lidhura me to vetëm si mbështetje në mirëbesim të veprimtarive sociale e publike dhe në rastet kur zyrtari publik nuk ushtron autoritet mbikëqyrës mbi shoqërinë ose kur shoqëria nuk është pjesë e ndonjë procedure administrative nën përgjegjësinë e zyrtarit publik. Kontributet/donacionet për bamirësi dhe sponsorizimet nuk mund të bëhen si shkëmbim nderesh me zyrtarin publik.

2. Shoqëria ofron dhurimet/

donacionet dhe sponsorizime në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe, në çdo rast, bën transparente identitetin e marrësit, shumën e marrë në formë dhurimi/donacioni ose sponsorizimi dhe me shkakun e dhurimit/donacionit ose sponsorizimit.

3. Në rast se një zyrtar publik kërkon një dhurim/donacion ose sponsorizim për një organizatë jofitimprurëse të caktuar, edhe në rast se këto organizata janë të njohura, kërkimi mund të konsiderohet si mitëmarrje në rast se dhurimi/donacioni ose sponsorizimi ndikon ose duket sikur ndikon në ushtrimin e parregullt të detyrës nga zyrtari publik. Shoqëria është e detyruar të refuzojë çdo kërkesë për kryerjen e një dhurimi/donacioni ose sponsorizimi në rastet kur një zyrtar publik premtan ndonjë përfitim të parregullt ose kërcënon me kryerjen ose moskryerjen e ndonjë veprimi të caktuar që mund të dëmtojë interesat e ligjshme të shoqërisë.

4. Në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit, shoqëria regjistron çdo kontribut dhe sponsorizim që bëhet për organet shtetërore dhe për zyrtarët publikë. Gjithashtu, shoqëria publikon në faqen e saj të internetit çdo dhurim/donacion ose sponsorizim që kryen.

Neni 8

Dhuratat, mikpritja dhe shpenzimet

1. Në raste të caktuara, dhuratat favoret apo trajtimet preferenciale mund të jenë të përshtatshme që njerëzit e biznesit t'i shprehin respektin njëri-tjetrit. Sidoqoftë, në përputhje me rregullat dhe procedurat për shpenzimet e mikpritjes, dhuratat duhet të jenë simbolike, të vogla dhe duhet të kenë çmim të arsyeshëm. Shoqëria nuk përdor dhurata apo favore për të ndikuar në vendimet e shoqërive tregtare të tjera. Punonjësit dhe agjentët/ndërmjetësit ose çdo palë e tretë të cilët mund të veprojnë në emër dhe për llogari të shoqërisë nuk u lejohet të japin apo të marrin dhurata, vakte, argëtime apo përfitime të tjera të mikpritjes të cilat kanë si qëllim ndikimin e parregullt tek një Zyrtar Publik apo tek çdo palë tjetër që bën biznes me shoqërinë.

2. Nuk lejohet të kryhen shpenzime të mikëpritjes në rast se mund të ndikojnë në mënyrë të parregullt, ose duket sikur ndikojnë në mënyrë të parregullt, tek rezultati i prokurimit apo i transaksioneve të tjera të biznesit si dhe kur nuk janë shpenzime të arsyeshme apo të kryera në mirëbesim.

Neni 9

Kontributet politike

1. Çdo kontribut politik i cili kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë, drejtpërdrejtë ose

tërthorazi, mund të bëhet vetëm me autorizimin e Administratorit/ Bordit të Drejtorëve/ Bordit Mbikëqyrës/ Mbledhjes së Aksionerëve. Këto kufizime zbatohen për të gjitha kontributet në para si dhe për çdo kontribut në natyrë apo edhe për shërbimet që jepen pa kundërshpërblim.

2. Në çdo rast, shuma që shoqëria mund t'i japë një subjekti politik nuk mund të jetë më e madhe se shuma e përcaktuar nga legjislacioni përkatës.ⁱ Gjithashtu, shoqërisë i ndalohet të japë kontribute për subjektet zgjedhore nëse (a) ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione gjatë 2 viteve të fundit, duke tejkaluar shumën e përcaktuar në legjislacionin përkatësⁱⁱ (b) ka qenë partnere me fonde publike në projekte të ndryshme dhe (c) ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit apo ndaj çdo institucioni publik.

3. Të gjitha kontributet duhet të regjistrohen në mënyrë të rregullt në librat dhe regjistrat e shoqërisë.

Neni 10

Konflikti i interesit

1. Gjendja e konfliktit të interesit ndodh kur interesat personale të punonjësve apo palëve të lidhura ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë vendimmarrjen e tyre në shoqëri. Shoqëria është e angazhuar të bëjë biznes në një formë që siguron se gjykimi dhe vendimmarrja e administratorëve, drejtorëve të

lartë, punonjësve dhe agjentëve/ndërmjetësve ose palëve të treta të cilët mund të veprojnë në emër dhe për llogari të shoqërisë, nuk ndikohet nga interesat personale të papërshtatshme.

2. Administratorët, zyrtarët dhe punonjësit, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shoqërisë për parandalimin e konfliktit të interesit, nuk duhet të përfshihen në ndonjë veprimtari që bie ndesh apo mund të ndikojë në përmbushjen e rregullt të detyrave të tyre funksionale në shoqëri.

3. Më poshtë, paraqitet një listë treguese e rasteve kur punonjësit mund të ndodhen në gjendjen e konfliktit të interesit. Për shembull, administratorët, drejtorët e lartë, punonjësit dhe agjentët/ndërmjetësit ose palët e treta të cilët mund të veprojnë në emër dhe për llogari të shoqërisë mund të ndodhen në gjendjen e konfliktit të interesit kur:

3.1. Kanë interes në ecurinë e biznesit dhe mirëqenien financiare të një furnitori, klienti ose konkurrenti;

3.2. Hyjnë në marrëdhënie kontraktuale apo marrin vendime biznesi duke qenë të motivuar nga interesi personal, pavarësisht nëse ky interes është financiar ose jo financiar;

3.3. Marrin përfitime financiare në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me ndërmjetësimin e palëve të treta, qoftë dhe në

formën e krijimit të një burimi financiar në të ardhmen, nga një furnitor, klient apo konkurrent;

3.4. Kërkojnë apo pranojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, dhurata, ndere, premtime ose trajtim preferencial nga furnitorët, klientët, konkurrentët apo zyrtarët publikë për shkak të pozicionit të tyre, në kundërshtim me politikat e shoqërisë;

3.5. Përdorin asetet e shoqërisë apo pozicionin e tyre për qëllime private.

4. Administratorët / drejtorët / punonjësit janë të detyruar të parandalojnë dhe të shmanginsa më parë që të jetë e mundur çdo gjendje të konfliktit të tij të interesit. Për këtë qëllim, punonjësit kanë përgjegjësi personale të:

4.1. jenë të vëmendshëm për ndonjë konflikt interesi faktik ose të mundshëm;

4.2. ndërmarrin hapa për të shmangur një konflikt të tillë;

4.3. t'i bëjnë me dije eprorit të tyre çdo gjendje të tillë konflikti sapo të marrin dijeni;

4.4. zbatojnë çdo vendim përfundimtar për t'u tërhequr nga situata apo për të hequr dorë nga përparësia që shkakton konfliktin.

Neni 11

Partnerët e biznesit dhe ndërmjetësit

1. Ky kod i sjelljes dhe çdo rregull dhe procedurë i miratuar në zbatim të tij janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo palë e tretë apo çdo subjekt tjetër tregtar që është nën kontrollin e shoqërisë.

2. Shoqëria, në përputhje me rregullat dhe procedurat e saj për vlerësimin e partnerëve të biznesit, agjentëve dhe ndërmjetësve, kryen vlerësimin e rrezikut kundër mitëmarjes për subjekte tregtare me të cilat bashkëpunon shoqëria. Kjo procedurë është e detyrueshme në rastet e marrëdhënieve të rëndësishme si bashkimet, përthithjet dhe investimet e tjera të rëndësishme. Të dhënat që kanë rezultuar nga një vlerësim i tillë duhet të ruhen për të paktën pesë(5) vite.

3. Shoqëria nuk hyn në marrëdhënie biznesi me subjekte biznesi që njihen apo ka dyshime të arsyeshme se paguajnë ose marrin ryshfete. Shoqëria nxit përdorimin dhe zbatimin e kodeve të sjelljes kundër korrupsionit me të gjithë partnerët e biznesit dhe palët e treta.

4. Shoqëria, në rast se çmohet e nevojshme dhe sipas rrethanave, monitoron marrëdhëniet e rëndësishme të biznesit. Në rast se është e nevojshme dhe palët kanë dhënë pëlqimin e tyre, shoqëria mund të auditojë librat dhe regjistrat e partnerëve të biznesit

dhe shoqërive të kontrolluara.

5. Shoqëria nuk kryen pagesa të parregullta nëpërmjet ndërmjetësimit të palëve të treta. Në përputhje me Kodin Civil, palët e treta shpërblehen sipas kushteve të ngjashme që përfitojnë zakonisht palët e tjera që kryejnë shërbime të njëjta/ngjashme në vendin ku ai ushtron aktivitetin e tij. Nëse nuk ekziston një praktikë e tillë zakonore, ndërmjetësi ka të drejtën për një shpërblim të arsyeshëm, duke pasur parasysh të gjitha aspektet e kontratës.

6. Agjentët dhe palët e tjera të treta, në përputhje me vlerësimin e rrezikut kundër korrupsionit, u nënshtrohen trajnimeve të posaçme mbi programin e shoqërisë kundër korrupsionit, duke ia përshtatur nevojave dhe rrethanave të veçanta të agjentëve dhe palëve të treta.

7. Shoqëria kryen prokurimin sipas procedurave që garantojnë një trajtim të barabartë dhe transparent, me qëllim që të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin dhe që sigurojnë një mirëpërdorim të fondeve dhe uljen e shpenzimeve procedurale.

8. Çdo kontratë që lidhet me një palë të tretë ose me një shoqëri tregtare e cila është nën kontrollin e shoqërisë duhet të përfshijë një nen kundër korrupsionit. Bashkëlidhur si shtojca A e këtij Kodi të Sjelljes gjendet një model i një neni kundër korrupsionit.

Neni 12

Kontrollet e brendshme dhe ruajtja e të dhënave

1. Shoqëria, në përputhje me rregullat dhe procedurat tona dhe me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit, zbaton standardet më të larta për ruajtjen e integritetit, saktësisë dhe besueshmërisë së regjistrave (librave), dhe pasqyrave financiare të shoqërisë.

2. Pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, ndryshimet në gjendjen financiare dhe rrjedhjen e parasë së shoqërisë dhe i lejojnë përdoruesve për të marrë vendime ekonomike. Për arritjen e këtij qëllimi, pasqyrat financiare përmbajnë informacione rreth: (a) aktiviteteve (b) detyrimeve (c) kapitaleve të veta (d) të ardhurave dhe shpenzimeve, duke përfshirë fitimin dhe humbjet (e) pasqyrën e ndryshimeve në kapitalet e vetadhe (f) rrjedhjen e parasë. Ky informacion, së bashku me informacionet e tjera që përmbajnë shënimet shpjeguese, ndihmojnë në mbajtjen e një niveli të lartë transparence, integriteti dhe besueshmërie të dokumenteve financiare.

3. Në përputhje me legjislacionin tatimor dhe standardet përkatëse të kontabilitetit, shoqëria regjistron të gjitha pagesat në libra, ditar dhe llogari në kohën kur ato ndodhin dhe informacioni mbi to paraqitet në mënyrë të tillë që të

jetë informues dhe i kuptueshëm për përdoruesit e pasqyrave financiare. Ndalohen paraqitja e informacioneve të pavërteta, ç'orientuese, të paplota, të pasakta ose artificiale në librat dhe regjistrat e shoqërisë.

4. Kontratat që lidh shoqëria me partnerët e biznesit dhe palët e tjera të treta duhet të paraqesin në mënyrë të saktë çmimin dhe kushtet e tjera financiare që palët kanë rënë dakord. Prandaj, regjistrat e shoqërisë duhet të pasqyrojnë në mënyrë të saktë të gjitha kushtet financiare të transaksioneve. Çdo transaksion që regjistrohet me informacione të pavërteta, ç'orientuese, të paplota, të pasakta ose artificiale në libra dhe regjistra, përbën shkak për fillimin e procedurës disiplinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Shoqëria nuk mund të kryejë transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë kur vlera e transaksionit është më e madhe se 150.000ⁱⁱⁱ Lekë. Si rregull, shoqëria kryen çdo transaksion shitjeje ose blerjeje nëpërmjet sistemit bankar. Në rast se nuk është e mundur të kryhet një transfertë bankare, shoqëria e regjistron transaksionin në mënyrë të saktë në librat e kontabilitetit të shoqërisë.

6. Shkelja e këtyre ligjeve dhe rregullave mund të sjellë përgjegjësi të shoqërisë dhe përgjegjësi personale të punonjësit.

Neni 13

Integriteti i punonjësve

1. Shoqëria beson se për zbatimin e këtij Kodi të Sjelljes është shumë e rëndësishme të punësohen punonjës që përkrasin vlerat dhe parimet e shoqërisë. Për këtë qëllim, shoqëria ruan integritetin e punonjësve duke zbatuar parimet e mëposhtme:

- 1.1. Shoqëria cakton një punonjës në pozicion drejtues vetëm nëse është verifikuar integriteti i atij punonjësi.
- 1.2. Emërimi i çdo punonjësi të ri në një detyrë nga administratori/departamenti i burimeve njerëzore duhet të kryhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e burimeve njerëzore (procedura e marrjes në punë, verifikimi para punësimit dhe verifikimet e përshtatshme rreth të shkuarës.
- 1.3. Administratori ose departamenti i burimeve njerëzore duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë për trajnimin kundër korrupsionit që i ofrohet punonjësve të cilët mund të ekspozohen ndaj praktikave të korrupsionit, veçanërisht nëse ata ndërveprojnë me zyrtarë publikë.
- 1.4. Shoqëria nuk punëson dhe nuk lidh marrëveshje shpërblimi me zyrtarë publikë pas dorëheqjes apo daljes

së tyre në pension si dhe me subjekte apo persona që kanë lidhje me ta. Ky kufizim është i zbatueshëm në rastet kur: (a) zyrtari publik ka pasur një funksion që mbikqyrte/kontrollonte/liçensonte veprimtaritë e shoqërisë; (b) zyrtari publik punësohet/kontraktohet për veprimtari që lidhen drejtpërdrejtë me funksionet e mbajtura apo të mbikëqyrura nga ai/ajo gjatë kohës në detyrë dhe (c) zyrtari publik punësohet/kontraktohet për veprimtari ose funksione publike ku ai/ajo ka aftësi të ushtrijë ndikim.

Neni 14

Auditimi

1. Shoqëria është e angazhuar të kryejë auditime të brendshme dhe të jashtme për të siguruar kryerjen e veprimtarisë në përputhje me ligjet kundër korrupsionit dhe për të zbuluar çdo transaksion që bie ndesh me këtë kod të sjelljes apo me rregullat e zbatueshme të kontabilitetit. Gjetjet e auditimeve të brendshme dhe të jashtme mund të përdoren për nisjen e veprimeve disiplinore ndaj punonjësve dhe për të përmirësuar programin e shoqërisë kundër korrupsionit.
2. Komisioni i Auditit/Administratori/Bordi/shoqëria e jashtme e auditit ka të drejtë të kryejë një vlerësim të pavarur të përshtatshmërisë së programit të shoqërisë për të parandaluar korrupsionin dhe

mitëmarrjen dhe të publikojë gjetjet në Raportin Vjetor. Ky raport publikohet në faqen e internetit të shoqërisë.

Neni 15

Ngritja e shqetësimeve dhe kërkesa për udhëzime

1. Shoqëria është e angazhuar të ofrojë udhëzime dhe këshilla për të gjithë punonjësit e saj, pavarësisht funksionit të tyre, dhe, kur është e përshtatshme, shoqëria mund t'i ofrojë udhëzime dhe këshilla edhe partnerëve të saj të biznesit, me qëllim që të zbatohet programi i shoqërisë kundër korrupsionit. Veçanërisht, shoqëria mund të japë udhëzime dhe këshilla për rastet kur punonjësit ose partnerët e biznesit kanë nevojë urgjente për këshilla për të zgjidhur situata të vështira. Për këtë qëllim, çdo pyetje në lidhje me zbatimin e këtij Kodi duhet t'i drejtohet Departamentit Ligjor ose Departamentit të Përputhshmërisë, ose nëse nuk ka të tilla, Administratorit.

2. Çdo person që nuk dëshiron të shkelë standardet e mira profesionale apo të etikës nën udhëzimin apo presionin e eprorëve të tij, si dhe çdo person i cili vihet në dijeni për veprime ose praktika të dyshuara korrupsioni, gjatë punës ose në lidhje me veprimtarinë e tij të punës në shoqëri, ka të drejtë të sinjalizojë këtë fakt, në kushtet e mirëbesimit dhe duke u bazuar në shkaqe të arsyeshme nxitet të raportojë këto

lloj rastesh tek njësia përgjegjëse për sinjalizuesit brenda organizatës me e-mail [xxx] ose telefon [xxx] ose tek ILDKPKI-ja.

3. Çdo raportim për shkeljen e këtij kodi sjellje do të shqyrtohet me përparësi. Raportimi duhet të përmbajë të paktën informacionet e mëposhtme: (a) të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit (b) përshkrimin e fakteve dhe rrethanave, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur (c) referimin përkatës në dispozitën e kodit penal, për aq sa është e mundur, të veprës ose praktikës së dyshuar të korrupsionit (d) në rastin e sinjalizimit të jashtëm, shkaqet ligjore dhe rrethanat e faktit, për aq sa është e mundur, për përdorimin e mekanizmit të sinjalizimit të jashtëm. Menjëherë pas përfundimit të hetimit të një raportimi, ajo shqyrtohet nga organi përgjegjës i shoqërisë, si departamenti i përputhshmërisë, ai ligjor ose auditit. Në rast se gjenden shkelje, ndaj punonjësit fillon procedura disiplinore në përputhje me rregullat dhe procedurat për burimet njerëzore.

4. Sipas dispozitave të ligjit për sinjalizuesit dhe në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, shoqëria ndalon çdo hakmarrje apo kërcënim për hakmarrje ndaj punonjësit që raporton një shkelje të dyshuar të ligjit, rregulloreve ose Kodit të Sjelljes së shoqërisë. Punonjësi mbrohet nga çdo veprim

hakmarrës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: (a) shkarkimin nga puna (b) pezullimin nga puna ose të një ose më shumë detyrave (c) transferimin brenda ose jashtë organizatës (d) uljen e pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare (e) humbjen e statusit dhe privilegjeve (f) mosngritjen në detyrë (g) heqjen e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime (h) vlerësime negative në marrëdhënien e punës dhe çdo lloj tjetër veprimi hakmarrës. Gjithashtu, çdo punonjës që shkruajon apo pengon të tjerët për të raportuar ose për të kërkuar ndihmë për të raportuar çështjen, i nënshtrohet veprimeve disiplinore.

Neni 16

Komunikimi dhe trajnimi

1. Të gjithë punonjësit e shoqërisë janë përgjegjës për të lexuar me kujdes dhe për të kuptuar këtë Kod të Sjelljes. Administratorët/Drejtorët janë të detyruar që të sigurohen që, brenda fushave të tyre të përgjegjësisë, ky kod i është shpërndarë punonjësve dhe çdo punonjës në varësi të tyre e ka lexuar dhe kuptuar atë.

2. Punonjësit që punojnë në departamente/sektorë të evidentuar si me rrezik të lartë ekspozimi ndaj mitëmarrjes dhe praktikave korruptive, janë të detyruar të marrin pjesë në trajnimin kundër mitëmarrjes dhe korrupsionit. Departamentet/sektorët e shoqërisë që kanë rrezik të lartë korrupsioni përcaktohen

në bazë të një vlerësimi të vazhdueshëm të rrezikut sipas Nenit 4 (3) të këtij Kodi të Sjelljes.

2. Në rast pyetjeve të përgjithshme rreth këtij kodi ose rreth rregullave dhe procedurave tona, kontaktoni {} në {}

Shtojca A:

Modeli i klauzolës kundër korrupsionit për kontraktimin e palëve të treta¹

Paragrafi 1

Palët zotohet që, në datën e hyrjes në fuqi të Kontratës, ato, drejtorët, zyrtarët, apo punonjësit e tyre nuk kanë ofruar, premtuar, dhënë, autorizuar, kërkuar apo pranuar asnjë shumë të papërshtatshme parash apo përparësi të tjera të çdo lloji (dhe nuk kanë nënkuptuar që mund të bëjnë një gjë të tillë në të ardhmen) në çfarëdo lloji mënyrë që lidhet me Kontratën dhe që kanë ndërmarrë masa të arsyeshme për të mos lejuar që kjo gjë të bëhet nga nënkontraktorët, agjentët dhe çdo palë tjetër e tretë, nën kontrollin apo ndikimin e tyre.

Paragrafi 2

Palët bien dakord që, gjatë gjithë kohës në lidhje me, gjatë dhe pas Kontratës, do të zbatojnë dhe do të marrin masa të arsyeshme për tu siguruar se nënkontraktorët, agjentët dhe palët e tjera të treta të tyre, të cilat i nënshtrohen

1- Klauzola kundër korrupsionit, © Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC), 2012, <http://www.iccwbo.org/Advocacy-Codes-and-Rules/Areas-of-work/Corporate-Responsibility-and-Anti-corruption/Business-Ethics-Documents/ICC-Anti-corruption-Clause/>

kontrollit dhe ndikimit të palëve, do të zbatojnë kodin e sjelljes kundër korrupsionit të shoqërisë, i cili është pjesë e Kontratës në formë reference por që lexohet sikur të ishte i shkruar në formë të plotë.

Paragrafi 3

Nëse njëra nga palët, si pasojë e ushtrimit të të drejtës së auditimit dhënë nga kontrata, nëse ka të tillë, për regjistrat e kontabilitetit dhe regjistrat financiarë të Palës tjetër, apo anasjelltas, sjell prova se Pala tjetër ka kryer shkelje apo shkelje të përsëritura të dispozitave të kodit të sjelljes kundër korrupsionit, ajo njofton Palën tjetër dhe kërkon nga kjo Palë të ndërmarrë veprimet e nevojshme ndreqëse brenda një afati të arsyeshëm dhe ta njoftojë atë rreth veprimit të ndërmarrë. Nëse pala tjetër nuk ndërmerr veprimin e nevojshëm ndreqës, ose nëse një veprim i tillë ndreqës nuk është i mundur, mund të kërkojë që pala të provojë se në kohën e daljes së provave për shkelje, ajo ka krijuar masa të përshtatshme për të parandaluar korrupsionin, të përshtatura sipas rrethanave të saj dhe të afta të dallojnë korrupsionin dhe të përkrahin kulturën e integritetit brenda organizatës. Nëse nuk ndërmerret asnjë veprim ndreqës ose, nëse ndodh që nuk provohet në mënyrë të efektshme një krijim masash si më sipër, Pala e parë mund, sipas gjykimit të sajë, të pezullojë Kontratën ose ta

përfundojë atë, duke qenë e qartë se të gjitha detyrimet kontraktuale në momentin e pezullimit apo përfundimit të Kontratës do të jenë të pagueshme, me aq sa lejohet nga legjislacioni në fuqi.

Paragrafi 4

Çdo subjekt, qoftë gjykatë arbitrazhi apo organ tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që merr vendim në përputhje me dispozitat e Kontratës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ka autoritetin të përcaktojë pasojat kontraktuale të ndonjë moszbatimi të pretenduar të kodit të sjelljes kundër korrupsionit të shoqërisë.

UDHËZUES PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT PËR KOMUNITETIN E BIZNESIT NË SHQIPËRI

KOMENTE TË PËRGJITHSHME

Praktikat e konkurrencës së ndershme nuk lënë vend për mitëmarrje, informalitet ose korrupsion. Parimet dhe procedurat e qarta dhe transparente përmirësojnë marrëdhëniet dhe komunikimin e biznesit, si brenda strukturës së vet, ashtu edhe me të gjithë aktorët e tjerë (d.m.th. klientët, furnitorët, investuesit dhe administratën publike).

Respektimi rigoroz i këtyre parimeve dhe procedurave do të sjellë si rezultat uljen e rrezikut të korrupsionit si

Kodi i Sjelljes kundër Korrupsionit nuk është:

- **dokument standard për çdo situatë**
Çdo biznes duhet të hartojë kodin e vet.
- **akt normativ detyrues**
Miratimi i kodit është zgjedhje.
- **praktikë dhe arritje afatshkurtër**
Ofron bazat për të hartuar një plan strategjik afatmesëm deri afatgjatë që përmirëson punën e biznesit.

dhe barrën e një trysnie të vazhdueshme të korrupsionit mbi operacionet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të biznesit, duke reduktuar shpenzimet operative dhe duke rritur pozitën dhe reputacionin e biznesit. "Orientimi" nga lart është thelbësor që biznesi të zbatojë Kodin

e Sjelljes. Zbatimi në shkallë të gjerë nga komuniteti i biznesit në Shqipëri kontribuon në forcimin e stabilitetit të vendit dhe parashikueshmërinë e investimeve, si edhe e bën komunitetin e biznesit tërheqës në nivel ndërkombëtar, bazuar në standarde etike të forta dhe në respektimin e akteve normative ndërkombëtare për aktivitetet ekonomike.

Nisur nga gjendja aktuale e komunitetit të biznesit në

Shqipëri, praktikat e zakonshme tregtare si dhe trysnia e vazhdueshme e korrupsionit në nivele të larta, miratimi i Kodit të Sjelljes mund të përbëjë kosto (afatshkurtër) për bizneset, por përfitimet në planin afatmesëm dhe afatgjatë janë të panumërta.




FIGURA 1- MINIMIZIMI I KOSTOVE TË KORRUPSIONIT DHE RREZIKET E MIRATIMIT TË KODIT TË SJELLJES KUNDËR KORRUPSIONIT

VLERËSIMI I RREZIKUT

Gjatë hartimit të Kodit të Sjelljes kundër Korrupsionit në sektorin privat, është thelbësore që të merren parasysh të gjithë rreziqet e mundshme që hasen në aktivitetet e biznesit, me qëllim që të zbatohen masa dhe politika efikase kundër mitëmarrjes dhe korrupsionit. Çdo biznes ndryshon nga të tjerët në përmasa, vendndodhje, tipologji, strukturë organizative, burimet që disponon, etj. Prandaj, çdo dokument kundër korrupsionit duhet të mbajë parasysh rreziqet e vetë biznesit dhe të kryejë një proces të posaçëm për vlerësimin e rrezikut (Transparency International, 2013). Pavarësisht mungesës së një modeli të standardizuar për vlerësimin e ekspozimit ndaj rrezikut, Manuali për Biznesin mbi Etikën kundër Korrupsionit dhe Respektimin e Normave (OECD, UNODC dhe BB, 2013), ofron një metodë me 6 hapa për realizimin e një vlerësimi rreziku efikas.



FIGURA 2- METODA ME 6 HAPA PËR REALIZIMIN E NJË VLERËSIMI RREZIKU EFIKAS

Sipas manualit, shoqëritë tregtare duhet të zbatojnë këto hapa:

1. Përcaktoni procesin

Kur shoqëria vendos të realizojë një vlerësim rreziku, është e këshillueshme që të organizohet një fokus-grup me partnerët kryesorë të biznesit, në mënyrë që të kuptohet perceptimi i tyre mbi rreziqet që has shoqëria. Ky aktivitet iu mundëson partnerëve që të shohin ekspozimin ndaj rreziqeve përmes një analize të hollësishme. Elementët kyçë që duhen mbajtur parasysh janë:

- Demonstrimi i përkushtimit të hartuesve – identifikimi i strukturës përgjegjëse për hartimin e politikës kundër korrupsionit (p.sh. departamenti ligjor, menaxhimi i rrezikut, etika dhe respektimi i normave);
- Përkushtimi i aktorëve kryesorë – përfshirja e aktorëve kryesorë përkatës;
- Identifikimi i harkut kohor dhe kostove indirekte–

identifikoni sa është koha e nevojshme për hartimin e politikës dhe sa janë kostot indirekte si pasojë e këtij procesi;

- Identifikimi i të dhënave dhe dokumenteve të nevojshme për vlerësimin e rreziqeve – identifikimi i tipologjisë së të dhënave që duhet të mbledhen, si dhe i metodologjisë së vlerësimit që është më e përshtatshme;
- Identifikimi i burimeve (p.sh. të brendshme dhe të jashtme) – identifikimi i burimeve të mundshme që nevojiten për të kryer vlerësimin;
- Ngritja e një kuadri referues për vlerësimin dhe menaxhimin e proceseve të rrezikut të korrupsionit.

2. Identifikoni rreziqet

Ky hap shërben për të grumbulluar të dhëna mbi faktorët e rreziqeve të korrupsionit, përmes përfshirjes së partnerëve, me disa mënyra:

- Kërkim në tavolinë;
- Raporte të brendshme;
- Dokumente të jashtme;
- Intervista;
- Anketa;
- Seminare;
- Seanca për rrahje idesh (diskutim)

3. Kategorizoni rreziqet e qenësishme

Qëllimi i këtij hapi është që rreziqet e korrupsionit të vlerësohen sipas një skeme logjike që ndërthur:

- ndikimin që mund të ketë;
- probabilitetin që të ndodhë;

Vlerësimi i rrezikut të qenësishëm të korrupsionit rrjedh nga kombinimi i këtyre dy aspekteve, përmes një shkalle të thjeshtë sasiore ose cilësore. Ky aktivitet i mundëson shoqërisë që të përpilojë një skemë të qartë ku vendos rreziqet më të rëndësishme të korrupsionit që kanë përparësi në përgjigjet që shoqëria duhet të planifikojë.

4. Identifikoni dhe kategorizoni masat zbutëse

Shoqëria duhet të zbatojë një proces me masa zbutëse ndaj çdo rreziku dhe skeme të identifikuar paraprakisht. Duhet të dallojë:

- masat e posaçme nga masat e përgjithshme;

- masat parandaluese nga ato zbuluese.
- Masat mund të kategorizohen përmes një shkalle cilësore dhe sasiore. Për të marrë informacion për masat zbutëse përkatëse, mund të jetë e dobishme të pyeten partnerët kryesorë, përmes intervistave ose anketave.

5. Llogaritni rrezikun e mbetur

Rreziku i mbetur është rreziku që një faktor i caktuar mund të përsëritet, pavarësisht se shoqëria ka zbatuar masa të posaçme për të kontrolluar këtë faktor rreziku. Prandaj, duhet të kryhet vlerësimi i rrezikut të mbetur, edhe nëse masat zbutëse ekzistuese janë efikase. Ky rrezik kategorizohet përmes një shkalle cilësore ose sasiore.

6. Hartoni planin e veprimit

Pasi identifikohen rreziqet e qenësishme dhe rreziqet e mbetura, si edhe masat zbutëse, shoqëria duhet të hartojë një plan veprimi të posaçëm i cili duhet t'i përgjigjet në mënyrë shteruese nevojave të shoqërisë.

Shoqëria duhet të shqyrtojë edhe mundësinë që të përgatisë dhe të zbatojë rregulla dhe procedura të përshtatshme për dokumentimin e rezultateve të vlerësimit të rrezikut që shoqëria kakryer (OECD, UNODOC dhe BB, 2013), si p.sh.:

- Regjistra rreziqesh (p.sh. baza e të dhënave ku paraqiten të gjithë faktorët e rrezikut dhe masat zbutëse përkatëse);
- Harta rreziku, d.m.th. ku klasifikohen rreziqet me ngjyra të ndryshme që përfaqësojnë një nivel të caktuar rreziku.

Është e rëndësishme të kuptohet që vlerësimi i rrezikut është një mjet që i lejon bizneset të kuptojnë sa efikase janë programet e tyre kundër korrupsionit dhe çfarë efektesh kanë te faktorët e rrezikut. Për më tepër, vlerësimi i rrezikut nuk duhet parë si proces statik, por duhet të zbatohet dhe të rishikohet periodikisht. Në fakt, masat dhe programet efikase kundër korrupsionit dhe mitëmarjes në sektorin e biznesit janë rezultat i vlerësimeve të rrezikut që kryhen herë pas here.

LLOGARITJA E KOSTOVE TË KORRUPSIONIT NË BIZNES

Korrupsioni është fenomen shumëplanësh që prek operacionet e bizneseve. Është e rëndësishme të jemi të vetëdijshëm për kostot e korrupsionit, sidomos në planin afatgjatë (Hameed, 2014). Shumë biznese argumentojnë se në disa raste, korrupsioni mund të lehtësojë funksionimin e burokracisë ekzistuese (d.m.th. me pagesa informale). Por, rreziqet /kostot e kësaj sjelljeje janë më të kushtueshme në planin afatgjatë. Në Raportin e Anketës së Biznesit kundër Mitëmarrjes 2015, një grup pyetjesh synonin të hulumtonin kostot e korrupsionit. "Të anketuarve iu kërkua të vlerësojnë sa mund të ishte kostoja e të gjitha pagesave informale, si përqindje e shitjeve totale që shoqëritë, të ngjashme me ato të të anketuarve, iu paguajnë zyrtarëve". "Përqindja totale e pagesave informale për të gjitha firmat është rreth 5% e shitjeve totale vjetore të tyre. Ngjashmëri vihet re edhe me rezultatet e anketës BEEPS të Bankës Botërore për Shqipërinë, ku deri 52.7% e bizneseve deklaruan se nuk kanë nevojë të japin pagesa informale "për të mbaruar punë", pra, e përafërt me 52% që rezulton nga kjo anketë për të njëjtën çështje". (OSCE & IDRA, 2015, p. Par. 7.3).

Është e vështirë të llogariten efektet negative të korrupsionit në biznese, për shkak se kryhen në mënyrë informale nëpërmjet kanaleve të fshehta. Por, është e zakonshme të gjesh indekse apo tregues (UNDP, 2015), që synojnë të masin nivelin / shkallën e korrupsionit përmes perceptimit të aktorëve kyç (p.sh. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit nga Transparency International, Barometri Global i Korrupsionit i TI, Anketat e Paguesve të Ryshfetit të TI, etj.), por, megjithatë është më e vështirë që të gjendet një model standard apo mekanizëm për matjen e kostove reale dhe ndikimit të korrupsionit. Gjithsesi, secili biznes duhet të jetë i vetëdijshëm për to, edhe pse nuk evidentohen lehtësisht në terma monetarë. Mbi të gjitha, bizneset duhet të mbajnë parasysh se lejimi i praktikave korruptive prek mjedisin e jashtëm dhe të brendshëm. Në fakt, disa nga kostot më të zakonshme janë:

- zhvendosja e burimeve financiare jashtë

- ekonomisë formale, gjë që çënon besueshmërinë e mjedisit të tregut;
- humbja e reputacionit, gjë që largohen investuesit që janë më “të orientuar drejt etikës”.

16 PARIMET E KODIT TË SJELLJES KUNDËR KORRUPSIONIT

Për hartimin e një Kodi Sjelljeje standard kundër Korrupsionit për Komunitetin e Biznesit në Shqipëri, ishte e nevojshme të analizohej struktura e disa Kodeve të Sjelljes, që shërbejnë si modele referuesenë nivel ndërkombëtar. Si shembull Manuali për Biznesin mbi Etikën kundër Korrupsionit dhe Respektimin e Normave (OECD, UNODOC dhe BB, 2013) kryen një krahasim të instrumenteve kryesore të biznesit kundër mitëmarjes dhe paraqet parimet bazë të tyre. Sipas analizës së kryer, u identifikuan 16 parime kryesore, që mishërojnë strukturën bazë të Kodit të Sjelljes standard për Komunitetin e Biznesit në Shqipëri. Ato paraqiten më poshtë:

1

GARANTIMI I ANGAZHIMIT TË BIZNESIT

Shoqëria angazhohet që të luftojë mitëmarrjen dhe korrupsionin, duke respektuar tërësisht ligjet dhe standardet e integritetit dhe etikës.

2

GARANTIMI I ZBATIMIT TË PLOTË

Kodi i Sjelljes zbatohet për të gjithë administratorët, punonjësit dhe individë apo subjekte që kryejnë transaksione me shoqërinë, për çdo transaksion që ato kryejnë.

3

GARANTIMI I KUPTIMIT TË PLOTË

Për të krijuar një kuptim të njëjtëtë termave të përdorur në Kodin e Sjelljes, prezantohen të gjithë përkufizimet kryesore.

4

GARANTIMI I MASAVE PARANDALUESE EFEKTIVE

Për të luftuar korrupsionin dhe mitëmarrjen, shoqëri krijon masa parandaluese dhe angazhohet që t'i përditësojë ato në mënyrë periodike.

5

GARANTIMI I VEPRIMEVE DISIPLINORE EFEKTIVE

Shoqëriandalon çdo formë korrupsioni dhe mitëmarrjeje. Sjelljet e papërshtatshme, të interpretuara në kuptimin më të gjerë të mundshëm, do të ndëshkohen.

6

GARANTIMI I RREGULLIMIT EFEKTIV TË PAGESAVE LEHTËSUESE

Shoqëriandalon çdo formë mitëmarrjeje, përfshirë pagesat lehtësuese dhe nxit të gjithë punonjësit që përballen me një kërkesë për pagesë lehtësuese që ta raportojnë atë tek drejtori tyre.

7

GARANTIMI I RREGULLIMIT EFEKTIV TË DONACIONEVE DHE SPONSORIZIMEVE

Çdo formë donacioni dhe sponsorizimi duhet të jetë transparente dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar. Nëse bëhen në mënyrë të papërshtatshme, ato do të konsiderohen rryshfet.

8

GARANTIMI I RREGULLIMIT EFEKTIV TË PRANIMIT/DHËNIES SË DHURATAVE

Dhuratat dhe shpenzimet e mikpritjes nuk duhet të ndikojnë tek vendimet e shoqërisë, edhe pse në disa raste të kufizuara mund të jetë e përshtatshme që ato të jepeni shenjë respekti dhe mirënjohjeje.

9

GARANTIMI I RREGULLIMIT EFEKTIV TË KONTRIBUTEVE POLITIKE

Të gjithë kontributet politike duhet të autorizohen nga bordi (apo organi i barasvlershëm me të) dhe, në çdo rast, duhet të jenë në përputhje me Kodin Zgjedhor.

10

GARANTIMI I PARANDALIMIT EFIKAS TË KONFLIKTIT TË INTERESIT

Asnjë vendim nuk duhet të ndikohet nga interesi vetjak.

11

GARANTIMI I ZBATIMIT TË PLOTË NGA PARTNERËT E BIZNESIT DHE NDËRMJETËSIT

Kodi zbatohet për të gjitha subjektet që kryejnë transaksioneme shoqërinë. Biznesi duhet të shmangë kryerjen e transaksioneve me subjekte që dyshohen se marrin apo japin rryshfet.

12

GARANTIMI I MONITORIMIT EFIKAS TË FLUKSIT FINANCIAR

Regjistrat, të dhënat dhe deklarimet financiare duhet të ruhen në mënyrë të arsyeshme me qëllim sigurimin e një niveli të lartë integriteti, transparence dhe besueshmërie.

13

GARANTIMI I INTEGRITETIT TË PUNONJËSVE

Shoqëriaduhet të marrë në punëpunonjës që përkrainvlerat dhe qëllimet e saj.

14

GARANTIMI I AUDITEVE TË BRENDSHME/TË JASHTME

Shoqëriaduhet të kryejë audite të brendshme dhe të jashtme me qëllim respektimin e ligjeve kundër korrupsionit dhe për të rritur nivelin e transparencës së saj.

15

GARANTIMI I RAPORTIMIT TË SHKELJEVE

Shoqëriaduhet t'u ofrojë udhëzime dhe këshilla gjithë drejtuesve, punonjësve dhe zyrtarëve për respektimin e Kodit të Sjelljes. Ata nxiten të raportojnë çdo situatë të vështirë dhe shoqërianuk duhet të lejojëkërcënime ndaj ndonjëpunonjësi që raporton shkelje të ligjit.

16

GARANTIMI I KOMUNIKIMIT EFIKAS

Të gjithë punonjësit kanë përgjegjësinë ta lexojnë dhe ta kuptojnë këtë Kod.

FAKTORËT E SUKSESIT

Zbatimi me sukses i këtij Kodi të Sjelljes kundër Korrupsionit kërkon zbatimin dhe respektimin e të gjitha parimeve të mësipërme. Miratimi, zbatimi dhe përkrahja e gjerë e tij janë të domosdoshëm për arritjen e rezultateve si pasojë e përpjekjeve të përbashkëta të komunitetit të biznesit.

Paragrafët më poshtë ofrojnë një përmbledhje të shkurtër të këshillave për çdo biznes në veçanti si dhe për komunitetin e biznesit në tërësi me qëllim që të forcohet roli që Kodi i Sjelljes kundër Korrupsionit mund të luajë për përkrahjen në Shqipëri të një mjedisi biznesi më të fortë.

REKOMANDIME PËR BIZNESIN

Lufta kundër korrupsionit dhe zbatimii detyrimeve ligjore dhe standardeve ndërkombëtare për konkurrencë të ndershme fillojnë me përpjekjet e secilit biznes. Për të siguruar zbatimin me efikasitet të Kodit të Sjelljes në një biznes, sugjerohet që:

- Pronarët e biznesit duhet të shprehin angazhimin e tyre duke përcaktuar vlerat e biznesit të tyre (p.sh. bërja biznes në mënyrë të drejtë, transparente dhe të ndershme) me qëllim luftën ndaj mitëmarrjes dhe korrupsionit;
- Punonjësit të angazhohen në mënyrë aktive në programin kundër korrupsionit;
- Procesi duhet të jetë i karakterizuar nga "Të udhëhequrit përmes shembullit personal". Në të vërtetë, lufta ndaj mitëmarrjes dhe korrupsionit është një proces që "vendoset nga lart": drejtuesi/administratori i biznesit duhet të jetë aktiv me qëllim mbrojtjen si duhet të biznesit dhe punonjësve të tij dhe garantimin e zbatimit të Kodit të Sjelljes. Përparësia kryesore e drejtuesit/administratorit të biznesit duhet të jetë qëllimi dhe vlerat etike që Kodi i Sjelljes mishëron;
- Biznesi duhet të jetë i përkushtuar për transparencë të plotë, dhe të vendosë në dispozicion dokumentet përkatëse të cilat duhet të hartohen me ekspertizë profesionale

- (p.sh. avokatë, auditues);
- Biznesi duhet të inkurajojë punonjësit e tij dhe këdo që has një situatë të vështirë t'ia raportojë atë sa më shpejt që të jetë e mundur departamentit përkatës/personit të kontaktit (në varësi të madhësisë së biznesit). Ajo ç'ka është më e rëndësishme, ai duhet të mbrojë sinjalizuesit, duke marrë edhe masa të posaçme mbrojtjeje në përputhje me ligjin në fuqi;
 - Biznesi duhet të nxisë krijimin e një komuniteti të drejtë e të moralshëm që është në gjendje t'i mbrojë anëtarët e tij përballë presioneve për korrupsion nga brenda apo jashtë shoqërisë (d.m.th. nga shteti). Ai duhet të përkrahë një mjedis të ndershëm dhe transparent;
 - Biznesi duhet ta miratojë Kodin e tij të Sjelljes në mënyrë publike (p.sh. duke tërhequr vëmendjen e medias), si dhe duke përkrahur monitorimin "informal" e publik të zbatimit të tij;
 - Biznesi duhet ta përdorë kodin e tij të sjelljes si një praktikë pozitive të marrëdhënieve të tij me publikun në raport me partnerët e tij të biznesit, investitorët, shoqëritë e sigurimeve dhe bankat, si dhe klientët e tij dhe me publikun. Miratimi i kodit të sjelljes, si dhe krijimi i vlerave etike të biznesit, tërheq investitorët e orientuar nga etika, besimi i të cilëve rritet falë reputacionit të mirë të biznesit.

REKOMANDIME PËR KOMUNITETIN E BIZNESIT

Zbatimi i suksesshëm i Kodit të Sjelljes kërkon përpjekje sinergjike të gjithë aktorëve kryesorë që punojnë brenda Komunitetit Shqiptar të Biznesit. Prandaj, jo vetëm biznese më vete por edhe shoqatat e tyre, dhoma e tregtisë, bizneset e huaja (dhe shoqatat e tyre), si edhe administrata publike, duhet të angazhohen që ta miratojnë, zbatojnë dhe përkrahin atë. Sugjerohet që:

- Organizatat e biznesit të angazhohen në mënyrë aktive për përkrahjen dhe miratimin e Kodit të Sjelljes duke miratuar një Kod Sjelljeje specifik për organizatën e tyre. Veç kësaj, edhe

pse secila organizatë biznesi mund të zhvillojë strategjitë e veta të promovimit, sugjerohet që të merret në konsideratë që njëri nga kushtet e anëtarësimit të jetë miratimi i një Kodi të Sjelljes;

- Organizatat e biznesit duhet të jenë në gjendje që të asistojnë dhe të mbështesin anëtarët për hartimin e një Kodi të Posaçëm të Sjelljes;
- Komuniteti i biznesit duhet të mbështesë trajnime për anëtarët bazuar në parimin "udhëheqje përmes shembullit", ku "kampionët etikë" mund të demonstrojnë përmes përvojës së tyre dobithë afatmesme – afatgjata të miratimit të një Kodi të Sjelljes;
- Komuniteti i biznesit duhet të rrisë perceptimin që mbështet dhe mbron "sinjalizuesit";
- Komuniteti i biznesit duhet të përfshijë edhe median me qëllim që të rritet ndërgjegjësimi i publikut dhe monitorimi nga ana e konsumatorit;
- Investitorët e huaj dhe sektori publik^{iv} duhet të shtjellojnë strategji të mundshme për të përfshirë miratimin e një Kodi të Sjelljes si një kusht "të parapëlqyeshëm" që bizneset të kenë qasje tek shërbimet e tyre (p.sh. "klauzola ISO").

REKOMANDIME NGA KOMUNITETI I BIZNESIT

Rekomandimet e mëposhtme përfaqësojnë gjetjen kyçe (ashtu siç është përmbledhur nga Biznes Albania) të 10 takimeve rajonale të organizuara me përkatësisht 200 aktorë kryesorë, përfshirë: shoqatat e biznesit, dhomat e tregtisë, dhe sipërmarrjet private. Takimet rajonale u organizuan nga Biznes Albania nën mandatin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe u mbajtën në rajonet e mëposhtme midis datave 4 tetor dhe 11 nëntor 2016: Vlorë, Lezhë, Fier, Berat, Kukës, Gjirokastër, Korçë, Durrës, Elbasan dhe Tiranë. Duke pranuar që Kodi Kundër Korrupsionit përfaqëson një mjet dijeje (më shumë sesa një rregullore të detyrueshme), aktorët që marrin pjesë në takimet rajonale (pra forumet konsultative rajonale) theksojnë rëndësinë e Kodit si një masë për rritjen e ndërgjegjësimit për shoqëritë dhe punonjësit e tyre, duke i kushtuar vëmendje të posaçme shoqërive

të vogla dhe mikro me struktura organizative të kufizuara. Reflektimet e mëposhtme u formuluan si pika kyçe për përhapjen dhe pranimin gjerësisht të Kodit:

1. Puna në partneritet–Zbatimi i Kodit nuk duhet të jetë ekskluzivisht përgjegjësi e shoqërive individuale. Për këtë qëllim janë paraqitur masat e mëposhtme:
 - a. Miratimi i Kodit si një masë kushtëzuese për miratimin e statutit nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
 - b. Fuqizimi i administratorëve që të kërkojnë krijimin e auditeve të brendshme (sidomos në shoqëritë e mëdha) për zbatimin e Kodit;
 - c. Veprimtari për rritjen e ndërgjegjësimit (brenda secilës shoqëri) ndërmjet punonjësve dhe partnerëve të huaj.
2. Trajnime horizontale dhe Udhëheqje 'përmes shembullit' – Komuniteti i biznesit në përgjithësi duhet të mbështesë trajnimet për anëtarët aty ku 'kampionët etikë' mund të demonstrojnë përmes përvojës së tyre dobitë e miratimit të Kodit të Sjelljes. Pjesëmarrës si Vodafone, Antea Cement, Green Recycling, Hygea Hospital Tirana, dhe Shega Trans mund të tregojnë sesi funksionon në praktikë Kodi i tyre;
3. Media dhe monitorimi i konsumatorëve – Komuniteti i biznesit duhet të angazhojë median për të rritur ndërgjegjësimin e publikut dhe monitorimin e konsumatorëve;
4. Përfshirja e investitorëve të huaj – Investitorët e huaj duhet të shtjellojnë strategji të mundshme për të përfshirë miratimin e një Kodi të Sjelljes si kusht "të parapëlqyeshëm" që bizneset të kenë qasje tek shërbimet e tyre.
5. Forcimi i rolit të shoqatave të biznesit dhe dhomave të tregtisë – Shoqatat e biznesit dhe dhomat e tregtisë duhet të ofrojnë mbështetje dhe të mbrojnë interesin e komunitetit të biznesit dhe transparencën e tij brenda sektorit privat dhe në lidhje me subjekte të treta (p.sh. investitorët e huaj dhe sektori publik):

- a. Organizatat e biznesit duhet të angazhohen për përkrahjen dhe miratimin e Kodit të Sjelljes. Edhe se secila organizatë biznesi mund të zhvillojë strategjitë e saj të përkrahjes, sugjerohet që të merret në konsideratë që njëra nga klauzolat e anëtarësisë të jetë miratimi i një Kodi të Sjelljes;
- b. Organizatat e biznesit duhet të jenë në gjendje që të ndihmojnë dhe mbështesin anëtarët për hartimin e Kodeve të Posaçme të Sjelljes.

PARIMI 1: GARANTIMI I ANGAZHIMIT TË BIZNESIT²

Parimi 1

Shoqëria angazhohet që të luftojë mitëmarrjen dhe korrupsionin, duke respektuar tërësisht ligjet dhe standardet e integritetit dhe etikës.



NË PRAKTIKË

Për të respektuar Parimin 1 të Kodit të Sjelljes, shoqëria duhet:

- Të përcaktojë vlerat e biznesit të tij, p.sh. transparencë, drejtësia dhe ndershmëria;
- Të veprojë sipas vlerave të tij, p.sh. duke pasur transparencë në lidhje me pagesat dhe me dokumentimin e tyre;
- Të parandalojë mitëmarrjen përmes zbatimit të një 'programi kundër korrupsionit' në mbështetje të vlerave të tij, p.sh. duke rishikuar dhe përditësuar në mënyrë të vazhdueshme Kodin e Sjelljes kundër mitëmarrës dhe masat parandaluese;
- Të mos japë apo ofrojë ndonjë lloj ryshfeti, p.sh. agentët nuk duhet të paguajnë ryshfet;
- Të përcaktojë veprime disiplinore për punonjësit që shkelin këto parime, p.sh. largim nga puna.



DISPOZITAT LIGJORE

Kodi penal e parashikon si vepër penale korrupsionin në sektorin privat³. Neni 164/a ndëshkon me burgim nga tre muaj deri në dy vjet dhe gjobë prej 200,000

deri në një milion lekë çdo premtim, propozim, ose dhënie drejtpërdrejt ose tërthorazi, të çdo lloj përfitimi të parregullt për vete ose një person të tretë, personit që ushtron funksion drejtues në shoqëri tregtare ose punon në çdo pozicion në sektorin privat për të kryer ose për të mos kryer një veprim, në kundërshtim me

² Imazhet e përdorura në këtë kre janë përgatitur nga Freepick dhe janë shpërndarë nga Flaticon

detyrën.

Ndërkohë që neni 164/b ndëshkon me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet dhe gjobë nga 300,000 deri në tre milionë lekë kërkimin a marrjen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të çdo lloj përfitimi të parregullt nga personi që ushtron funksion drejtues ose punon në çdo pozicion në sektorin privat me qëllim që të kryejë ose të mos kryejë një veprim, në kundërshtim me detyrën.

Një vepër penale mund të kryhet nga persona fizikë (individë) dhe persona juridik (shoqëri, OJF, dhe persona të tjera juridik). Personat juridik kanë përgjegjësi penale për veprat penale të kryera: (a) në emër ose në dobi të tij, nga organet dhe përfaqësuesit e tij; (b) në emër ose në dobi të tij, nga një person që është nën autoritetin e një personi që përfaqëson, drejton, dhe administron personin juridik; (c) në emër ose në dobi të tij, për shkak të mungesës së kontrollit apo të mbikëqyrjes nga personi që drejton, përfaqëson dhe administron personin juridik^{vi}. Një kod i sjelljes kundër korrupsionit për shoqëritë tregtare shqiptare mund të përdoret si mjet për të mbrojtur këto shoqëri nga ndjekja penale duke treguar se shoqëria ka procedurat e duhura për të parandaluar që drejtorët/punëmarrësit saj dhe persona të tjerë të lidhur me ta të ndërmarrin praktika korruptive.

Veç kësaj, praktikat korruptive përkeqësojnë aftësitë e shoqërive për të konkurruar për kontrata prokurimi publik. Ligji parashikon që një ofertë mund të refuzohet kur (a) ofertuesi apo kandidati i jep ose premtion t'i japë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një zyrtari apo punonjësi një shpërblim në çfarëdolloj forme, mundësi punësimi ose mall, shërbim ose vlerë, si stimul për një akt, vendim apo procedurë, që ndërmerr autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit b) ofertuesi ose kandidati është në kushtet e konfliktit të interesit^{vii}. Përveç kësaj, ligji parashikon një përjashtim të përgjithshëm të shoqërive të dënuara për praktika korruptive në procedurat e prokurimit. Ligji parashikon në mënyrë të posaçme që çdo kandidat apo tenderues, i dënuar me vendim gjykatë të formës së

prerë për korrupsion, mashtrim, pastrim parash apo pjesëmarrje në organizata kriminale, përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurat e tenderit.

Angazhimi i shoqërisë për të zbatuar një kod të sjelljes kundër korrupsionit duhet të miratohet nga organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë, në përputhje me ligjin Nr. 9901 'Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare' (i ndryshuar).



NË BIZNESIN TUAJ

Për të respektuar Parimin 1 të Kodit të Sjelljes, administratori i shoqërisë duhet t'i bëjë vetes pyetjet e mëposhtme:

- A po i respekton të gjitha ligjet dhe praktikat përkatëse biznesi im për të luftuar mitëmarrjen dhe korrupsionin?
- A ka zbatuar biznesi im një program kundër korrupsionit?
- A janë aksionerët dhe anëtarët e bordit, si edhe punonjësit, të angazhuar për të respektuar politikën e biznesit?
- A ju duhet aksionerëve, anëtarëve të bordit dhe punonjësve në biznesin tim të nënshkruajnë një deklaratë me shkrim për zbatimin e parimeve të Kodit të Sjelljes?
- A po japin aksionerët, anëtarët e bordit dhe punonjësit mbështetje aktive dhe angazhim për zbatimin e Kodit të Sjelljes?
- A janë përcaktuar veprime disiplinore të qarta në biznesin tim për ata që shkelin Kodin e Sjelljes?



TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT

Cilat duhet të jenë veprimet tuaja të para bazuar në këtë parim? Përdorni hapësirën më poshtë për të shënuar

idetë tuaja fillestare:



SHEMBULL: Gazsjellësi Trans Adriatic (TAP) AG është një shoqëri e ngritur për të planifikuar,

zhvilluar dhe ndërtuar gazsjellësin e gazit natyror nga rajoni Kaspik në Evropë. Gjatësia e TAP-it në territorin shqiptar është përkatësisht 215 kilometra në tokë dhe 37 km në det. TAP-i punëson përafërsisht 80 specialistë të gazit dhe naftës nga shumëvende dhe më shumë se 200 ekspertë nga shoqëri të kontraktuara shërbimi. TAP-i ka miratuar një kod të detajuar sjelljeje të quajtur "të jetojmë vlerat tona" që mbulon, ndër të tjera, një seksion për ndalimin e mitëmarrjes dhe korrupsionit. Duke miratuar dhe zbatuar këtë Kod të Sjelljes, TAP-i merr një angazhim publik për të vepruar në mënyrë etike dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. TAP-i ka pranuar që korrupsioni dëmton zhvillimin ekonomik të vendeve dhe shtrembëron konkurrencën e lirë dhe, në të njëjtën kohë, prish reputacionin dhe integritetin e shoqërive duke ekspozuar si individët ashtu dhe shoqëritë ndaj rreziqeve ligjore dhe dëmtimit të reputacionit. TAP-i është kundër çdo lloj forme korrupsioni dhe ka marrë përsipër që të bëjë përpjekje aktive për të garantuar që të mos ketë korrupsion në asnjë hallkë të biznesit të tij. Në mbështetje të kodit të tij të sjelljes, TAP-i ka miratuar një politikë Kundër Mitëmarrjes dhe Kundër Korrupsionit. (Trans Adriatic Pipeline).

PARIMI 2: GARANTIMI I ZBATIMIT TË PLOTË

Parimi 2

Kodi i Sjelljes zbatohet për të gjithë drejtorët, punonjësit dhe individët apo subjektet që kryejnë transaksione me shoqërinë për çdo transaksion që ata kryejnë.



NË PRAKTIKË

Për të respektuar Parimin 2 të Kodit të Sjelljes, shoqëria duhet:

- T'u shpërndajë të gjithë aksionerëve, anëtarëve të bordit dhe punonjësve Kodin e Sjelljes së biznesit, p.sh. duke u dhënë një kopje, përmes komunikimit dhe sesioneve të trajnimit;
- T'u shpërndajë Kodin e Sjelljes të gjithë bashkëpunëtorëve dhe partnerëve të jashtëm, p.sh. duke u dhënë nga një kopje, përmes praktikave të mira të komunikimit;
- Të garantojë që punonjësit e shoqërisë dhe partnerët janë të gatshëm të respektojnë parimet e Kodit të Sjelljes, p.sh. duke i bërë ata të nënshkruajnë një deklaratë përputhshmërie, duke i pyetur partnerët nëse ata kanë një Kod të tyre të Sjelljes dhe duke kërkuar që t'ju japin një kopje të tij;
- Të shmangë bërjen e biznesit me partnerë që nuk respektojnë parimet e Kodit të Sjelljes, p.sh. përzgjedhje të partnerëve dhe bashkëpunëtorëve.



NË BIZNESIN TUAJ

Për të respektuar Parimin 2 të Kodit të Sjelljes, administratori i shoqërisë duhet t'i bëjë vetes pyetjet e mëposhtme:

- A i respektojnë të gjithë aksionerët, anëtarët e bordit dhe punonjësit parimet e Kodit të Sjelljes?
- A janë informuar të gjithë aksionerët, anëtarët e bordit dhe punonjësit për parimet e shoqërisë?
- A janë organizuar sesione trajnimi në shoqërinë time?
- A janë përzgjedhur me kujdes partnerët në shoqërinë time?

- A janë njoftuar partnerët dhe bashkëpunëtorët si dhe shoqëritë e kontrolluara nga shoqëria mëmë për parimet e tij?
- A ju duhet partnerëve dhe bashkëpunëtorëve si dhe shoqërive të kontrolluara të nënshkruajnë një deklaratë përputhshmërie me vlerat e Kodit të Sjelljes?



TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT

Cilat do të ishin veprimet e para bazuar në këtë parim? Përdorni hapësirën më poshtë për të përshkruar idetë

paraprake:



SHEMBULL: Verbundi është një shoqëri energjitike Austriake që punon në Shqipëri përmes Energji Ashta sh.p.k. Energji Ashta ka ndërtuar dhe operon përmes një kontrate koncesioni Hidrocentralin e Ashtës që ka kapacitetin për të prodhuar më shumë se 50 MGW energji elektrike. Verbundi ka një sistem menaxhimi të përbërë, ndër të tjera, nga udhëzime kundër korrupsionit. Grupi Verbund në tërësi është i integruar brenda Organizatës së Përputhshmërisë Verbund. Praktikrat e drejta të biznesit dhe udhëzimet kundër korrupsionit janë të zbatueshme në të gjithë Grupin, duke përfshirë shoqëritë e kontrolluara dhe partnerët tregtarë. (Verbund, 2017)

PARIMI 3: GARANTIMI I KUPTIMIT TË PLOTË

Parimi 3

Për të krijuar një kuptim tënjëjtë të termave të përdorur në Kodin e Sjelljes, prezantohen të gjithë përkufizimet kryesore.



NË PRAKTIKË

Për të respektuar Parimin 3 të Kodit të Sjelljes, shoqëriaduhet:

- Të ofrojë për të gjithë aksionerët, anëtarët e bordit, si dhe punonjësit, një listë të qartë dhe të plotë të përkufizimeve të përdorura te Kodi i Sjelljes, p.sh. duke u dhënë atyre një kopje, përmes komunikimit, dhe/ose trajnimeve;
- Të garantojë që të gjithë aksionerët, anëtarët e bordit dhe punonjësit të dinë kuptimin e termave të përdorur te Kodi i Sjelljes, p.sh. duke organizuar në mënyrë periodike trajnime dhe seanca vlerësuese;
- Të garantojë që të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm të jenë në dijeni të terminologjisë së Kodit të Sjelljes, p.sh. duke ju ofruar atyre përkufizime të termave përkatëse kryesore të përdorur në Kod.



NË BIZNESIN TUAJ

Për të respektuar Parimin 3 të Kodit të Sjelljes, administratori i shoqërisë duhet t'i bëjë vetes pyetjet e mëposhtme:

- A i kanë marrë të gjithë aksionerët, anëtarët e bordit, si dhe punonjësit përkufizimet e termave të përdorur te Kodi i Sjelljes?
- A i kuptojnë të gjithë aksionerët, anëtarët e bordit, dhe punonjësit termat e përdorur te Kodi i Sjelljes?
- A janë mbajtur trajnime/seanca vlerësimi në biznesin tim?
- A e kuptojnë terminologjinë e Kodit të Sjelljes të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm?



TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT

Cili duhet të jetë veprimi juaj i parë për këtë parim? Përdorni hapësirën më poshtë për të dhënë idetë tuaja fillestare:



SHEMBULL: AGNA Group është një prej shoqërive më të mëdha në Shqipëri për shpërndarjen dhe pronat e paluajtshme. AGNA Group ka krijuar një Akademi për Leadershipin, një prej akademive të para në Shqipëri dhe në Ballkan për zhvillimin e punonjësve. Akademia ndihmon punonjësit të rriten profesionalisht duke kuptuar dhe përqafuar praktikat më të mira në bërjen biznes dhe duke kultivuar një kulturë leadershipi. Akademia ka staf trajnues të përhershëm, si edhe profesorë që vizitojnë akademinë duke sjellë përvojë mësimdhënieje nga rajoni dhe BE-ja. Secili modul trajnimi është hartuar për t'u zbatuar drejtpërsëdrejti për përmirësimin e praktikave të biznesit. (AGNA GROUP)

PARIMI 4: MASAT PARANDALUESE EFEKTIVE

Parimi 4

Për të luftuar korrupsionin dhe mitëmarrjen, shoqëria krijon masa parandaluese dhe angazhohet që t'i përditësojë ato në mënyrë periodike.



NË PRAKTIKË

Për të respektuar Parimin 4 të Kodit të Sjelljes, shoqëriaduhet:

- Të krijojë një program parandalimi kundër korrupsionit, p.sh. duke mësuar nga përvoja dhe duke bashkëpunuar me të tjerët;
- Të krijojë një kuadër organizativ të përqendruar tek lufta kundër korrupsionit, p.sh. duke i atribuar rol dhe përgjegjësi të posaçme secilit individ pjesë e organikës së shoqërisë;
- Të rregullojë veprimtaritë e shoqërisë kundër korrupsionit, p.sh. duke zbatuar procedura të posaçme pune dhe rregulla për secilin sektor pune;
- Të përditësojë vazhdimisht masat kundër korrupsionit, p.sh. duke bërë vlerësimin e rrezikut, në mënyrë periodike.



DISPOZITAT LIGJORE

Disa masa minimale parandaluese janë garantuar tashmë nga legjislacioni aktual në fuqi. Neni 13 i ligjit nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", ndalon përgjithësisht që personat, të cilët

kanë qenë të dënuar për krime të kryera në kuadër të detyrave të tyre në shoqëri, të kryejnë funksionet e përfaqësuesit ligjorë të një shoqërie tregtare, anëtarëve të Këshillit të Administrimit apo Këshillit Mbikëqyrës, dhe as përfaqësues të aksionerëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Përveç kësaj, ligji për sipërmarrësit dhe shoqëritë^{viii} ka vendosur rregullat për konfliktin e interesit dhe të drejtës së personave të autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë, për të lidhur kontrata, apo për të vendosur marrëdhënie të tjera me shoqërinë. Një kërkesë e rëndësishme e ligjit është detyrimi për të bërë të ditur në pasqyrat financiare

dhe raportet e ecursisë së veprimtarisë transaksionet midis shoqërisë dhe personave të autorizuar për ta përfaqësuar ose mbikëqyrur shoqërinë. Ky detyrim kërkon që informacioni të përfshijë kushtet e transaksionit dhe natyrën dhe objektin e interesave të personave të përfshirë.

Administratori, në rastet e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, dhe Këshilli i Administrimit, në rastet e shoqërive aksionare, është përgjegjës për garantimin e zbatimit të masave parandaluese kundër korrupsionit^{ix}.

Për të garantuar masa efektive parandaluese, në kontratën e punës dhe në kontratën kolektive të punës duhet të parashikohen masa disiplinore. Kodi i Punës^x parashikon se procedura disiplinore duhet të garantojë të drejtën e punëmarrësit për t'u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova brenda një afatitë arsyeshëm.



NË BIZNESIN TUAJ

Për të respektuar Parimin 4 të Kodit të Sjelljes, administratori i shoqërisë duhet t'i bëjë vetes pyetjet e mëposhtme:

- Kush duhet të përfshihet në vendosjen e masave parandaluese në shoqërinë time?
- A duhet të përfshij individë/subjekte të jashtme për të zbatuar masat kundër korrupsionit në shoqërinë time?
- A janë të përcaktuara qartë rolet dhe përgjegjësitë në shoqërinë time?
- A janë të përcaktuara qartë rregullat dhe procedurat e punës në shoqërinë time?
- A është zbatuar vlerësimi i rrezikut në shoqërinë time?



TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT

Cili duhet të jetë veprimi juaj i parë në lidhje me këtë parim? Përdorni hapësirën më poshtë për të dhënë idetë tuaja fillestare:



SHEMBULL: Vodafone, një prej grupeve kryesore të telekomunikimit në botë, ka përgatitur një program të suksesshëm kundër korrupsionit për të përmbushur standardet e larta të paraqitura në Kodin e saj të Sjelljes. Programi kundër mitëmarrjes i Vodafone përqendrohet tek angazhimi i punonjësve të tij. Në mënyrë që të parandalojë korrupsionin, shoqëria ka zhvilluar kurse të reja online: punonjësit duhet të vënë në zbatim parimet e Kodit në rrethana të vërteta për të garantuar që e kanë kuptuar Kodin dhe rolin e tyre brenda shoqërisë (VODAFONE).

PARIMI 5: GARANTIMI I VEPRIMEVE DISIPLINORE EFEKTIVE

Parimi 5

Shoqëria ndalon çdo formë korrupsioni dhe mitëmarrjeje.

Sjelljet e papërshtatshme, të interpretuara në kuptimin më të gjerë të mundshëm, do të ndëshkohen.



NË PRAKTIKË

Për të respektuar Parimin 5 të Kodit të Sjelljes, shoqëria duhet:

- Të marrë masa disiplinore kundrejt cilitdo që shkel parimet e Kodit të Sjelljes, p.sh. ndërprerje të marrëdhënieve të punës;
- Të përfshijë në kontratat e punës së drejtorëve dhe punonjësve të tjerë masat dhe procedurën disiplinore;
- Të garantojë që të gjithë aksionerët, anëtarët e bordit, si dhe punonjësit, janë në dijeni të politikës së biznesit për zero tolerancë ndaj korrupsionit, p.sh. duke i informuar ata për veprimet disiplinore;
- Të garantojë që të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët kanë dijeni që biznesi nuk e toleron aspak korrupsionin, p.sh. duke shpërndarë një dokument të plotë për këto çështje;
- Të shkurajojë sjelljet e papërshtatshme, p.sh. përmes kontrolleve periodike të transaksioneve të biznesit.



DISPOZITAT LIGJORE

Çdo formë korrupsioni dhe mitëmarrjeje është vepër penale. Kodi Penal parashikon veprat e mëposhtme penale të korrupsionit:

- Korrupsioni aktiv në sektorin privat^{xi}
- Korrupsioni pasiv në sektorin privat^{xii}
- Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike^{xiii}
- Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë^{xiv}
- Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë^{xv}

- Korrupsioni pasiv i funksionarëve publikë^{xvi}
- Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë^{xvii}
- Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë^{xviii}
- Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit^{xix}
- Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë^{xx}
- Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare^{xxi}
- Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj^{xxii}
- Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja^{xxiii}
- Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë^{xxiv}
- Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare^{xxv}
- Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj^{xxvi}
- Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja^{xxvii}



NË BIZNESIN TUAJ

Për të respektuar Parimin 5 të Kodit të Sjelljes, administratori i shoqërisë duhet t'i bëjë vetes pyetjet e mëposhtme:

- A janë përcaktuar qartë sjelljet e papërshtatshme në shoqërinë time?
- A janë zbatuar procedurat dhe masat disiplinore në shoqërinë time?
- A janë të gjithë aksionerët, anëtarët e bordit dhe punonjësit në dijeni të masave dhe procedurave disiplinore?
- A janë të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët në dijeni të procedurave dhe masave disiplinore?



TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT

Cilat do të ishin veprimet e para që do të ndërmerrnit për këtë parim? Përdorni hapësirën më poshtë për të dhënë idetë tuaja fillestare:



SHEMBULL: United Parcel Service (UPS) është një prej shoqërive më të mëdha në botë të menaxhimit të zinxhirit të dërgesave, logjistikës dhe furnizimit. UPS vepron në Shqipëri përmes një kontraktuesi të autorizuar për shërbimet. Në mënyrë që të lehtësojë menaxhimin e veprimeve në të gjithë botën, UPS ka miratuar një Kod të Sjelljes së Biznesit. Kodi dhe Manuali i Politikave të UPS-it janë mjetet kryesore për të përcjellë përgjegjësitë e shoqërisë tek të gjithë aktorët kryesorë, të brendshëm dhe të jashtëm. Kodi parashikon që punonjësit dhe përfaqësuesit e UPS-it (përfshirë kontraktuesin e autorizuar shqiptar), që shkelin përgjegjësitë ligjore apo etike mund t'i nënshtrohen masave disiplinore, përfshirë ndërprerjen e punësimit. (UPS, 2011)

PARIMI 6:

GARANTIMI I RREGULLIMIT

EFEKTIV TË PAGESAVE LEHTËSUESE

Parimi 6

Shoqëria ndalon çdo formë mitëmarrjeje, përfshirë pagesat lehtësuese dhe nxit të gjithë punonjësit që përballen me një kërkesë për pagesë lehtësuese që ta raportojnë atë tek drejtori i tyre.



NË PRAKTIKË

Për të respektuar Parimin 6 të Kodit të Sjelljes, shoqëria duhet:

- Të refuzojë çdo lloj pagese të pandershme, p.sh. duke dhënë/kërkuar faturë në çdo rast;
- Të risë ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve kryesorë, anëtarëve të bordit, si edhe punonjësve për rreziqet afatgjata të pagesave lehtësuese, p.sh. duke organizuar trajnime përkatëse;
- Të lejojë që punonjësit e përfshirë në një situatë që ka të bëjë me një pagesë lehtësuese, ta raportojnë atë, p.sh. duke siguruar që eprorët e tyre të qëndrojnë pranë tyre për t'i ndihmuar;
- Të krijojë masa mbrojtëse për "sinjalizuesit", p.sh. duke garantuar konfidencialitetin maksimal.



DISPOZITAT LIGJORE

Edhe pagesat lehtësuese, që janë në shumata të vogla që jepen për të garantuar apo përshpejtuar kryerjen e një veprimi rutinë, bien nën fushëveprimin e Nenit

244 të Kodit Penal. Pra, edhe një pagesë prej 50 Euro mund të ndëshkohet me burg nga 6 muaj deri në tre vjet dhe gjobë nga 300,000 deri në një milion lekë.



NË BIZNESIN TUAJ

Për të respektuar Parimin 6 të Kodit të Sjelljes, administratori i shoqërisë duhet t'i bëjë vetes pyetjet e mëposhtme:

- A janë në dijeni, në shoqërinë time, aksionerët, anëtarët e bordit, dhe punonjësit për rreziqet afatgjata të pagesave lehtësuese?
- A ka masa disiplinore në shoqërinë time për të

- ndëshkuar pagesat lehtësuese?
- A ka ndonjë person në shoqërinë time tek i cili mund të drejtohem për të raportuar kërkesat për pagesa lehtësuese?
- A ka masa mbrojtëse në shoqërinë time për të shmangur çdo formë hakmarrjeje, diskriminimi apo penalizimi?



TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT

Cilat do të ishin veprimet tuaja të para për këtë parim? Përdorni hapësirën më poshtë për të dhënë disa ide fillestare:



SHEMBULL: Shell është një nga shoqëritë më të mëdha të naftës në botë. Ajo operon në Shqipëri që nga viti 2012 përmes Shell Up stream Albania. Pagesat lehtësuese mund të perceptohen si praktikë e zakonshme në Shqipëri, edhe pse të paligjshme. Shell ka parashikuar në kodin e tij të sjelljes se nuk ka dallime mes rryshfetit dhe pagesave të lehtësimit dhe se të dyja janë njëloj të ndaluara. (SHELL, 2006)

PARIMI 7: GARANTIMI I RREGULLIMIT EFEKTIV TË DONACIONEVE DHE SPONSORIZIMEVE

Parimi 7

Çdo formë donacioni dhe sponsorizimi duhet të jetë transparent dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar. Nëse bëhen në mënyrë të papërshtatshme, ato do të konsiderohen rryshfet.



NË PRAKTIKË

Për të respektuar Parimin 7 të Kodit të Sjelljes, Shoqëria duhet:

- Të ketë dijeni se donacionet dhe sponsorizimet duhet të bëhen sipas legjislacionit shqiptar, p.sh. duke identifikuar kanalet zyrtare të bamirësisë;
- Të shmangë dhënien e donacioneve për dikë me të cilin vetë shoqëria ka një marrëdhënie biznesi p.sh. duke u siguruar që paratë t'i jepen gjithmonë një organizate dhe jo një individ;
- Të jetë transparent, p.sh. duke hartuar një kontratë sponsorizimi dhe dokumente të qarta për regjistrimin e të dhënave.



DISPOZITAT LIGJORE

Grantet janë përcaktuar si ofrim i fondeve ose i bazës materiale përmes një kontrate ose marrëveshjeje, sipas një procedure të përcaktuar konkurrimi, për realizimin e veprimtarisë së organizatës jofitimprurëse, në përputhje me qëllimin dhe fushën e veprimtarisë së saj, të përcaktuara në statut^{xxviii}.

Dhurimi ose donacioni përkufizohet si ofrim i fondeve ose i bazës materiale përmes një kontrate ose një marrëveshjeje për të mbështetur realizimin e qëllimit të një organizate jofitimprurëse^{xxix}.

Për garantimin e një rregullimi efektiv të donacioneve dhe sponsorizimeve duhet të merret parasysh se organizata jofitimprurëse mund të ketë si burime të të ardhurave kuotizacionet, kur ka të tillë, grante dhe donacione të ofruara nga subjekte private dhe publike, vendase ose të huaja, si dhe të ardhura

nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të organizatës jofitimprurëse^{xxx}.

Organizatat jofitimprurëse sigurojnë të ardhura nga burime që njihen nga ky ligj dhe bëjnë shpenzime vetëm për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë për të cilin janë krijuar, si dhe për drejtimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë së tyre.

Vetëm veprimtaritë sociale dhe publike mund të sponsorizohen. Përveç kësaj, këto veprimtari duhet të ndërmerren nga subjektet publike, institucione, shoqata dhe organizata të tjera të njohura me ligj^{xxxii}. Çdo sponsorizim duhet të rregullohet me kontratë të lidhur nga sponsorizuesi dhe përfituesi. Çdo sponsorizim, në para ose në natyrë, do të dokumentohet në pajtim me legjislacionin tatimor kontabël e bankar në fuqi^{xxxiii}.



NË BIZNESIN TUAJ

Për të respektuar Parimin 7 të Kodit të Sjelljes, administratori i shoqërisë duhet t'i bëjë vetes pyetjet e mëposhtme:

- A janë të gjithë aksionerët, anëtarët e bordit dhe punonjësit në dijeni të rreziqeve të dhënies së donacioneve dhe sponsorizimeve jashtë dispozitave ligjore?
- A janë të gjithë aksionerët, anëtarët e bordit dhe punonjësit nës hoqërinë time, në dijeni të legjislacionit shqiptar në fuqi?
- A janë pasqyruar qartësisht dhe janë bërë transparente dokumentet në biznesin tim (lidhur me donacionet dhe sponsorizimet, si deklaratat me shkrim, marrëveshjet e sponsorizimit)?



TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT

Cilat do të ishin veprimet tuaja të para për këtë parim? Përdorni hapësirën më poshtë për të dhënë idetë tuaja fillestare:



SHEMBULL: GlaxoSmithKline (GSK) është një shoqëri globale e kujdesit shëndetësor që vepron në Shqipëri që nga viti 2004. GSK ka mbi 100.000 punonjës dhe vepron në më shumë se 100 vende. Në këto kushte një kod i sjelljes është domosdoshmëri për shoqërinë me qëllim përcaktimin e pritshmërive si një komunitet i bashkuar nga vlerat. Si pjesë të kodit të tyre, ata kanë rregulla mbi grantet dhe donacionet. Kodi përcakton se GSK mbështet kauzat e ligjshme dhe të denja në komunitetet ku vepron. Për këtë qëllim, GSK ka miratuar një politikë dhe procedura operative të posaçme (POP) për grantet dhe donacionet. Politika parashikon që propozimet për grante rishikohen nga Komiteti i Granteve dhe Donacioneve, pasi miratohen nga një Njësi për Informacionin Mjekësor.

PARIMI 8: GARANTIMI I RREGULLIMIT EFEKTIV TË DHURATAVE DHE SHPENZIMEVE TË MIKPRITJES

Parimi 8

Dhuratat dhe shpenzimet e mikpritjes nuk duhet të ndikojnë tek vendimet e shoqërisë, edhe pse në disa raste të kufizuara mund të jetë e përshtatshme që ato të jepen si shenjë respekti dhe mirënjohjeje.



NË PRAKTIKË

Për të respektuar Parimin 8 të Kodit të Sjelljes, shoqëria duhet:

- Të shmangë çdo sjellje që mund të ndikojë vendimet e shoqërisë, p.sh. duke refuzuar që të japë/të marrë dhurata apo favore gjatë negociatave të biznesit;
- Të shmangë marrjen/dhënien e sendeve me vlerë;
- Të shmangë marrjen/dhënien e dhuratave rregullisht;
- Të monitorojë atë që ofrohet dhe pranohet.



DISPOZITAT LIGJORE

Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë apo të pranojë, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, dhurata, favore, premtime apo trajtim preferencial, të cilat jepen

për shkak të pozicionit të tij^{xxxiii}.

Ky ndalim bëhet në nenin 10 të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike" që shprehet se "Nëpunësi i administratës publike nuk duhet të kërkojë ose të pranojë, dhurata, ndere, pritje ose çfarëdo përfitim tjetër, ose shmangie të humbjeve të mundshme, si dhe premtime për to, për veten, familjen, të afërmit, personat ose organizatat me të cilat ka marrëdhënie, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës, apo janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare."

Rregullat e hollësishme për veprimtaritë e jashtme të zyrtarëve publikë si dhe dhuratat dhe favorët



NË BIZNESIN TUAJ

Për të respektuar Parimin 8 të Kodit të Sjelljes, administratori i shoqërisë duhet t'i bëjë vetes pyetjet e mëposhtme:

- Në cilin moment ndikon tek vendimet e shoqërisë një dhuratë/nder?
- Pse ofrohet një dhuratë/nder?
- Kush do të përfitojë nga një dhuratë/nder?
- Ç'lloj dhurate mund të konsiderohet e përshtatshme?
- Në shoqërinë time, a ka politikë të qëndrueshme për dhënien/marrjen e dhuratave/favoreve?
- A i njohin rregullat e shoqërisë mbi këtë çështje të gjithë aksionerët, anëtarët e bordit dhe punonjësit?



TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT

Cilat do të ishin veprimet tuaja të para për këtë parim? Përdorni hapësirën më poshtë për të dhënë idetë tuaja fillestare:



SHEMBULL: Price water house Coopers Albania shpk (PwC) është një shoqëri për taksat dhe shërbimet e auditimit; firmë anëtare e Rrjetit Botëror të firmave PwC. Duke qenë një shoqëri e bazuar në shërbime, integriteti i fortë dhe profesionalizmi janë kryesore për suksesin e modelit të tyre të biznesit. Për këtë arsye, PwC ka miratuar dhe zbaton një kod sjelljeje, i cili synon të demonstrojë integritetin e shoqërisë duke mos u angazhuar kurrë në mitëmarrje apo praktika korruptive. Kodi ka një politikë shumë të rreptë përsa i takon dhuratave. Pagesat në natyrë, duke përfshirë dhuratat, mund të jenë rryshfet, prandaj kodi i sugjeron punonjësve që të jenë veçanërisht të kujdesshëm kur kanë të bëjnë me klientët e sektorit publik. (PwC, 2012).

PARIMI 9: GARANTIMI I RREGULLIMIT EFEKTIV TË KONTRIBUTEVE POLITIKE

Parimi 9

Të gjithë kontributet politike duhet të autorizohen nga bordi (apo organi i barasvlershëm me të) dhe, në çdo rast, duhet të jenë në përputhje me Kodin Zgjedhor.



NË PRAKTIKË

Për të respektuar Parimin 9 të Kodit të Sjelljes, shoqëria duhet:

- Të garantojë transparencë, p.sh. duke ofruar materiale të qarta raportimi dhe duke bërë publike pasqyrat financiare;
- Të shmangë dhënien e kontributeve për partitë politike që kanë ndërmarrë nisma me qeverinë ose Kuvendin për çështje që ndikojnë tek biznesi;
- Të shmangë dhënien e kontributeve politike drejtpërsëdrejti tek një individ.



DISPOZITAT LIGJORE

Partitë politike nuk mund të marrin kontribute politike në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Neni 17, i ligjit nr. 8580, të datës 17.02.2000 "Për partitë politike" parashikon që:

Burimet financiare dhe materiale të partive politike përbëhen nga kuotat e anëtarësisë, nga fondet publike, duke përfshirë edhe ndihmën financiare në masën e caktuar në Buxhetin e Shtetit të miratuar me ligj nga Kuvendi, fondet jopublike, të cilat janë dhurimet financiare, dhurimet në natyrë, shërbimet, sponsorizimet, kreditë apo garancitë e ndryshme, si edhe çdo transaksion tjetër financiar.

Përveç kësaj, Kodi Zgjedhor kufizon kontributet politike për qëllime të fushatave zgjedhore vetëm nga personat fizikë dhe juridikë vendas^{xxxiv}.

Shuma që çdo person fizik apo juridik mund t'i japë një subjekti zgjedhor nuk mund të jetë më e madhe sesa 1 milion lekë ose vlera e barasvlershme në natyrë

ose shërbime^{xxxv}. Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksioner i tij, nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme: a) ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 2 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë; b) ushtron veprimtari në fushën e medias; c) ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme; ç) ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik. Ky detyrim nuk zbatohet nëse aksioneri i zotëron këto aksione si rezultat i ofertës publike^{xxxvi}.



NË BIZNESIN TUAJ

Për të respektuar Parimin 9 të Kodit të Sjelljes, administratori i shoqërisë duhet t'i bëjë vetes këto pyetje:

- A mbështet shoqëria ime ndonjë parti politike?
- A mbështet shoqëria ime ndonjë fushatë zgjedhore?
- Pse i intereson shoqërisë time të mbështesë një parti politike/fushatë zgjedhore?
- A janë të vetëdijshëm të gjithë aksionerët, anëtarët e bordit dhe punonjësit për kërkesat e Kodit Zgjedhor?
- A duhet që shoqëria ime të zbatojë një politikë të posaçme për të regjistruar kontributet politike?



TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT

Cilat do të ishin hapat tuaj të para për këtë parim? Shfrytëzoheni hapësirën më poshtë për të paraqitur idetë tuaja

paraprake:



SHEMBULL: Raiffeisen Bank sh.a. është një nga bankat e licencuara për kryerjen e aktivitetit bankar nga Banka e Shqipërisë. Raiffeisen Bank sh.a. është pjesë e Raiffeisen Bank

International, një bankë me seli në Austri, lider në Evropën Qendrore dhe Lindore. Raiffeisen Bank i ka rregulluar kontributet politike në Kodin e saj të Sjelljes. Sipas këtij Kodi, kontributet mund të vendosen vetëm nga Bordi Menaxhues dhe vetëm kur përmbushin këto kushte: (a) nuk shkelin asnjë normë ligjore; (b) janë brenda normave të zakonshme në Shqipëridhe (c) nuk kanë arsye të kenë ndonjë ndikim të papërshtatshëm. Sidoqoftë, kontributet duhet të jenë transparente dhe të konsultohen me Departamentin e Përputhshmërisë së Raiffeisen Group. (RAIFFEISEN, 2017)

PARIMI 10:

GARANTIMI I PARANDALIMIT

EFIKAS TË KONFLIKTIT TË INTERESIT

Parimi 10

Asnjë vendim nuk duhet të ndikohet nga interesi vetjak.



NË PRAKTIKË


Për të respektuar Parimin 10 të Kodit të Sjelljes, Shoqëria duhet:

- Të ndërgjegjësojë drejtorët dhe punonjësit e tij për mënyrat se si mund të ndodhë një konflikt interesi, p.sh. duke organizuar trajnime për skenarët e konflikteve të mundshme;
- Të sigurojë transparencë në çdo proces përzgjedhjeje, p.sh. duke bërë publike dokumente të veçanta;
- Të përcaktojë zgjidhje të mundshme për shmangien e situatave të konfliktit, p.sh. duke ofruar udhëzime për mënyrën se si duhen trajtuar këto situata.



DISPOZITAT LIGJORE

Siç theksohet më sipër, ligji për tregtarët dhe shoëritë tregtare^{xxxvii} përmban rregulla të hollësishme për konfliktin e interesit dhe për të drejtën e personave të autorizuar për të përfaqësuar ose mbikëqyrur shoqërinë në lidhjen e kontratave apo në marrëdhëniet e tjera me shoqërinë. Një kërkesë e rëndësishme e ligjit është detyrimi për të bërë publike transaksionet midis shoqërisë dhe përfaqësuesve dhe mbikëqyrësve të saj në pasqyrat financiare dhe raportet e ecursisë së veprimtarisë. Në këto publikime duhet të bëhen të ditura edhe kushtet e transaksioneve dhe natyra dhe objekti i interesave të personave të përfshirë në to.



NË BIZNESIN TUAJ

Për të respektuar Parimin 10 të Kodit të Sjelljes, administratori i Shoqërisë duhet

t'i bëjë vetes këto pyetje:

- A janë të vetëdijsëm të gjithë aksionerët, anëtarët e bordit dhe punonjësit për konfliktet e interesit që mund të krijohen brenda shoqërisë?
- A e ka përcaktuar shoqëria ime qartë se kur mund të ndodhë një konflikt interesi?
- A e dinë të gjithë aksionerët, anëtarët e bordit dhe punonjësit se si t'i shmangin dhe si t'i trajtojnë konfliktet e mundshme të interesit? A organizon biznesi im trajnime për ndërgjegjësimin e të gjithë aksionerëve, anëtarëve të bordit dhe punonjësve?



TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT

Cilët do të ishin hapat tuaj të parë për këtë parim? Shfrytëzoheni hapësirën më poshtë për të paraqitur idetë tuaja

paraprake:



SHEMBULL: Telekom Albania është pjesë e DeutscheTelekom, një shoqëri ndërkombëtare në fushën e Teknologjisë dhe Komunikimit, e cila operon në Shqipëri që në vitin 2015. Si pjesë të politikave të saj të përputhshmërisë, Telekom Albania ka, ndër të tjera, edhe një Kod të Sjelljes, një kod etike për drejtuesit e lartë financiarë dhe një politikë për shmangien e konflikteve të interesave dhe për luftën ndaj korrupsionit. Kjo politikë rregullon konfliktin e interesit që rrjedh nga punësimi i dytë, investimet private dhe përdorimi privat i aseteve të shoqërisë. (TELEKOM)

PARIMI 11: GARANTIMI I ZBATIMIT TË PLOTË NGA PARTNERËT E BIZNESIT DHE NDËRMJETËSIT

Parimi 11

Kodi aktual zbatohet për të gjitha subjektet që veprojnë me shoqërinë. Shoqëria duhet të shmangë kryerjen e transaksioneve me subjekte që dyshohen se marrin apo japin ryshfet.



NË PRAKTIKË

Për të respektuar Parimin 11 të Kodit të Sjelljes, Shoqëria duhet:

- Të marrë masat që të gjithë partnerët/subjektet me të cilat ajo punon të jenë të informuar në lidhje me programin kundër korrupsionit të shoqërisë, p.sh. duke u ofruar atyre kodin kundër korrupsionit;
- T'i pyesë partnerët e saj të biznesit dhe ndërmjetësit e saj nëse kanë një kod sjelljeje dhe të mundohet të marrë një kopje;
- Të kujdeset që Kodi i Sjelljes të jetë pjesë e kontratave/marrëveshjeve që mund të lidhen me to.



DISPOZITAT LIGJORE

Vlerësohet se ekziston një marrëdhënie mëmë-shoqëri e kontrolluar, kur një shoqëri tregtare sillet e vepron rregullisht

sipas orientimeve dhe udhëzimeve të një shoqërie tjetër (grup kontrollues)^{xxxviii}.

Duhet bërë dallimi midis subjekteve të cilat janë nën kontrollin e shoqërisë dhe agjentëve/degëve. Neni 950 i Kodit Civil parashikon se ekziston një marrëdhënie agjencie kur njëra palë merr përsipër në mënyrë të vazhdueshme dhe me shpërblim që të lidhë kontrata në një zonë të caktuar për llogari të palës tjetër.

Sa i përket shpërblimit të drejtë dhe të arsyeshëm të agjentëve/ndërmjetësve, Neni

953 i Kodit Civil parashikon se: Në mungesë të ndonjë marrëveshjeje ndërmjet palëve mbi këtë çështje, agjenti tregtar ka të drejtën e shpërblimit që agjentët tregtarë, të caktuar për kontratat që formojnë objektin e kontratës së tij të agjencisë, përfitojnë zakonisht në vendin ku ai ushtron aktivitetin e tij. Nëse nuk ekziston një praktikë e tillë zakonore, agjenti tregtar duhet të ketë të drejtën për një shpërblim të arsyeshëm, duke pasur parasysh të gjitha aspektet e kontratës. Konsiderohen si shpërblim i agjentit të gjitha elementet e pagesës që përfiton ai dhe që ndryshojnë sipas numrit apo vlerës së veprimeve tregtare. Në mungesë të zakoneve të tilla, agjenti tregtar ka të drejtën e një shpërblimi të arsyeshëm, që merr parasysh të gjitha elementet që kanë të bëjnë me veprimin.



NË BIZNESIN TUAJ

Për të respektuar Parimin 11 të Kodit të Sjelljes, administratori i shoqërisë duhet t'i bëjë vetes këto pyetje:

- Me çfarë partnerësh dhe bashkëpunëtorësh merret shoqëria ime?
- A janë në dijeni të Kodit të Sjelljes së shoqërisë kundër Korrupsionit të gjithë bashkëpunëtorët/partnerët e biznesit/ndërmjetësit?
- A ka shoqëria ime procedura të përshtatshme për monitorimin e marrëdhënieve të biznesit?
- A u jep shoqëria ime të gjithë bashkëpunëtorëve/partnerëve të biznesit/ndërmjetësve kopje të Kodit të Sjelljes?
- A u ofron shoqëria ime trajnime për ndërgjegjësimin mbi këtë program të gjithë bashkëpunëtorët/partnerët e biznesit/ndërmjetësit?
- A kanë miratuar bashkëpunëtorët/partnerët e biznesit/ndërmjetësit e shoqërisë si me kodet e tyre të sjelljes?



TË UDHËHEQËSH DUKE DHËNË SHEMBULLIN TËND

Cilët do të ishin hapat tuaj të parë për këtë parim? Shfrytëzojeni hapësirën më poshtë për të paraqitur idetë tuaja paraqake:



SHEMBULL: Vodafone synon të sillet sipas standardeve më të larta të integritetit dhe u kërkon furnitorëve të vet në të njëjtën kohë që të veprojnë në përputhje me politikën dhe detyrimet e Vodafone për furnitorët. Përveç kësaj, siç parashikohet në kodin e tij të etikës, Vodafone mund t'i monitorojë furnitorët e vet dhe të raportojë mbi zbatimin prej tyre të këtij Kodi, duke përdorur një metodologji të bazuar te rreziku. (Politikat e Vodafone për palët e treta).

PARIMI 12: GARANTIMI I MONITORIMIT EFIKAS TË FLUKSIT FINANCIAR

Parimi 12

Regjistrat, të dhënat dhe deklaratimet financiare duhet të ruhen në mënyrë të arsyeshme me qëllim sigurimin e një niveli të lartë integriteti, transparence dhe besueshmërie.



NË PRAKTIKË

Për të respektuar Parimin 12 të Kodit të Sjelljes, shoqëria duhet:

- Të sigurojë kontrole financiare, p.sh. duke vendosur kontrole të brendshme kontabiliteti;
- Të evidentojë parregullsitë, p.sh. duke siguruar një administrim të mirë përmes të dhënave të sakta me shkrim;
- Të shmangë shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve, p.sh. duke trajnuar të gjithë punonjësit për monitorimin e flukseve të parasë;
- Të evidentojë mungesën e transparencës në pagesa, p.sh. duke monitoruar kushtet e kontratave.



DISPOZITAT LIGJORE

Rregullat dhe parimet e përgjithshme për përgatitjen e standardeve kombëtare të kontabilitetit dhe pasqyrave kontabël rregullohen me ligjin Nr. 9228, datë 24 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar ("ligji i kontabilitetit").

Sipas ligjit të kontabilitetit, për njësitë ekonomike, duke përfshirë edhe njësitë ekonomike që nuk ndjekin qëllime fitimprurëse (siç janë OJQ-të) të vendosura në Shqipëri, duke përfshirë edhe institucionet financiare dhe degët e tyre, pavarësisht formës së tyre ligjore, duhet t'i mbajnë llogaritë në përputhje me parimet dhe metodat e përcaktuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Mikronjësitë përjashtohen shprehimisht nga ky detyrim.

Pasqyrat financiare përgatiten dhe paraqiten në gjuhën shqipe dhe vlerat shprehen në njësinë monetare kombëtare. Ato duhet të justifikohen me

dokumentacion mbështetës, i cili duhet të ruhet së bashku me të dhënat kontabël për 10 vjet pas mbylljes së vitit financiar.

Subjektet që nuk e tejkalojnë xhiron apo vlerën totale të aseteve prej 10 milion lekë në fund të vitit dhe që kanë më pak se 10 punonjës përkufizohen si mikronjësi ekonomike dhe mund t'i mbajnë të dhënat e tyre kontabël e t'i përgatisin pasqyrat financiare sipas kritereve të përcaktuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe të miratohen nga Këshilli i Ministrave. Të gjitha subjektet duhet të vendosin një sistem kontabiliteti në përputhje me planet e kontabilitetit lëshuar dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave. Përveç kësaj, janë edhe dy plane të tjera kontabiliteti (a) Plani i Kontabilitetit për Bankat që mbulon bankat tregtare, dhe (b) Plani Publik i Kontabilitetit që mbulon institucionet e qeverisë qendrore dhe vendore.

Viti ushtrimor kontabël përbëhet nga 12 muaj të njëpasnjëshëm dhe fillon me vitin kalendarik. Të dhënat kontabël duhet të mbahen dhe të ruhen në lekë dhe në gjuhën shqipe. Transaksionet në monedha të huaja lejohen të bëhen përmes llogarive të posaçme në monedhat përkatëse. Megjithatë, një herë në muaj dhe në fund të vitit ushtrimor, llogaritë në monedha të huaja duhet të konvertohen në lekë. Të gjithë librat kontabël, dokumentet mbështetëse dhe raportet financiare duhet të ruhen për një periudhë 10-vjeçare. Normalisht, librat dhe të dhënat kontabël mund të ruhen edhe nga palë të treta me përjashtim të rasteve të specifikuara me ligj.

Ligji Nr. 9228, datë 29 prill 2004 për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare vendosi për herë të parë disa standarde kontabiliteti. Ky ligj përfshin konceptin e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit, që shërbejnë si bazë për përzgjedhjen e trajtimit apo metodave të kontabilitetit në fuqi në përgatitjen ose paraqitjen e pasqyrave financiare.

Standardet e lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit janë përkthyer në gjuhën shqipe nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe janë botuar në faqen e internetit të Këshillit.



NË BIZNESIN TUAJ

Për të respektuar Parimin 12 të Kodit të Sjelljes, administratori i Shoqërisë duhet t'i bëjë vetes këto pyetje:

- A janë vendosur kontrole të përshtatshme financiare në shoqërinë time?
- A zbatohen në shoqërinë time kontrollet e duhura të monitorimit të kushteve të kontratave?
- A e dinë të gjithë aksionerët, anëtarët e bordit dhe punonjësit se si mbahen pasqyrat financiare në mënyrë të rregullt?
- A është ngritur një departament i posaçëm monitorimi në shoqërinë time?
- A është organizuar trajnim specifik në shoqërinë time?



TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT

Cili do të ishte hapi i parë për këtë parim? Shfrytëzoni hapësirën më poshtë për të paraqitur idetë tuaja paraprake:



SHEMBULL: SNAM (Società Nazionale Metanodotti), një nga shoqëritë lider në ndërtim dhe në menaxhimin e integruar të infrastrukturës së gazit natyror ka ndërtuar një strukturë të suksesshme monitorimi që përfshin Departamentin e Auditit të Brendshëm të Snam-it. Ky departament rishikon dhe shqyrton në mënyrë të pavarur sistemin e brendshëm të kontrollit për të garantuar përmbushjen e kërkesave të Procedurës së Kundër Korrupsionit. Për personelin e Auditit të Brendshëm është organizuar një trajnim specifik fokusuar tek ligjet kundër korrupsionit, mbajtja e librave kontabël dhe sistemi i brendshëm i kontrollit. (SNAM, 2013)

PARIMI 13:

GARANTIMI I INTEGRITETIT TË PUNONJËSVE

Parimi 13

Biznesi duhet të marrë në punë punonjës që përmbushin vlerat dhe qëllimet e tij.



NË PRAKTIKË

Për të respektuar Parimin 13 të Kodit të Sjelljes, Shoqëria duhet:

- Të ruajë integritetin punonjësve, p.sh. duke u ofruar trajnim të përshtatshëm për respektimin e ligjit;
- Të marrë masat që të gjithë ta kuptojnë qëllimin e Kodit dhe përgjegjësinë e tyre për zbatimin e tij, p.sh. duke i njohur punonjësit me këtë dokument;
- T'i informojë punonjësit mbi pasojat disiplinore të shkeljes së Kodit, p.sh. duke organizuar seanca trajnimi.



DISPOZITAT LIGJORE

Kontratat dhe marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.

Kodi i Punës parashikon rregulla specifike për (a) lidhjen, ndryshimin dhe ndërprerjen e kontratave të punës, duke përfshirë edhe fleksibilitetin e punësimit përmes kontratave me kohë të pjesshme dhe plotë, shkaqet dhe rregullat e njoftimit për heqjen nga puna, rregullat parësore për largimin nga puna dhe për shpërblimin për vjetërsi në punë (b) orët e punës, shpërblimet për punë jashtë orarit, mungesat, ditët e pushimeve dhe leja e pagueshme vjetore dhe paga minimale (c) kushtet e punës dhe rregullat disiplinore (d) kompensimi dhe përgjegjësitë kontraktuale të palëve në një kontratë pune (e) mbrojtjen e posaçme të disa kategorive të punonjësve (f) Proçedura e ristrukturimit në rastet e shkurtimit të numrit të punonjësve.

Një nga qëllimet kryesore të legjislacionit shqiptar të punës është krijimi i një niveli minimal mbrojtjeje

për punonjësit. Si rezultat, Kodi i Punës, si dhe i gjithë legjislacioni shqiptar që lidhet me të, përmban disa rregulla të detyrueshme që duhet të respektohen nga punëdhënësi në punësimin e punonjësve.

Në kontratën e punës dhe në kontratat kolektive të punës duhet të parashikohen masa disiplinore. Kodi i Punës parashikon garantimin e së drejtës për t'u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova brenda një afati të arsyeshëm.



NË BIZNESIN TUAJ

Për të respektuar Parimin 13 të Kodit të Sjelljes, administratori i shoqërisë duhet t'i bëjë vetes këto pyetje:

- A janë të vetëdijshëm të gjithë aksionerët, anëtarët e bordit, si dhe punonjësit për rëndësinë e Kodit kundër korrupsionit?
- A u ofron shoqëria ime trajnim të gjithë aksionerëve, anëtarëve të bordit dhe punonjësve për rritjen e ndërgjegjësimit të tyre për vlerat etike të biznesit?
- A është përkufizuar "integriteti" qartësisht në biznesin tim?
- A janë të gjithë aksionerët, anëtarët e bordit, dhe punonjësit të vetëdijshëm për pasojat disiplinore të shkeljes së Kodit?



TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT

Cilët do të ishin hapat tuaj të parë për këtë parim? Shfrytëzoheni hapësirën më poshtë për të paraqitur idetë tuaja

paraprake:



SHEMBULL: ING është një institucion financiar që u ofron shërbime bankare klientëve në më shumë se 40 vende. Duke marrë parasysh tregun tejet të rregulluar që operon, ING ka disa mekanizma për garantimin e respektimit të ligjit dhe rregulloreve, duke përfshirë edhe një rregullore

për menaxhimin e rrezikut, parimet kundër rryshfetit, një politikë sinjalizimi dhe një kod etike për rekrutimin për aplikimet nga jashtë shoqërisë. Si pjesë e kodit të etikës së rekrutimit, ING-ja, për pozicione specifike, me pëlqimin e aplikantit, ndërmerr edhe verifikime të të shkuarës së tij/saj. Këto verifikime vlerësojnë moralin dhe integritetin e aplikantit në lidhje me pozicionin për të cilin aplikojnë. (ING, 2015)

PARIMI 14: GARANTIMI I AUDITEVE TË BRENDSHME/TË JASHTME

Parimi 14

Shoqëria duhet të kryejë audite të brendshme dhe të jashtme me qëllim respektimin e ligjeve kundër korrupsionit dhe për të rritur nivelin e transparencës së shoqërisë.



NË PRAKTIKË

Për të respektuar Parimin 14 të Kodit të Sjelljes, shoqëria duhet:

- Të ngrejë një Komitet Auditimi ose të bëjë auditim të jashtëm me auditues profesionistë;
- Të lejojë këta të fundit që të bëjnë një vlerësim të pavarur për të parë se sa i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm është Kodi i Sjelljes kundër korrupsionit.



DISPOZITAT LIGJORE

Auditimi rregullohet me Ligjin Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e Profesionet të Audituesit ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar" (i

ndryshuar) ("ligji i auditit").

Ligji i auditit kërkon që pasqyrat financiare të subjekteve që plotësojnë disa kriteret të auditohen në mënyrë të pavarur pasqyrat financiare nga një auditues i çertifikuar. Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese (a) të gjitha shoqëritë tregtare, pavarësisht formës së tyre ligjore, që zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, (b) të gjitha shoqëritë aksionere që zbatojnë standardet kombëtare të kontabilitetit; (c) të gjitha shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar që zbatojnë standardet kombëtare të kontabilitetit, kur plotësohen të paktën dy nga këto kushte: (i) Totali i aseteve në fund të periudhës financiare përkatëse është i barabartë me ose më i lartë se 50 milion lekë, (ii) Xhiroja totale e aktivitetit ekonomik të periudhës financiare është e barabartë me ose më e madhe se 100 milion lekë (iii) Numri mesatar i punonjësve është

të paktën 30 gjatë periudhës financiare^{xxxix}.

Siç parashikohet nga ligji i shoqërive, aksionerët me një interes pjesëmarrjeje prej të paktën 5% ose në një masë më të vogël në rast se parashikohet në statutin e shoqërisë, si dhe çdo kreditor me një ekspozim të aksioneve në qarkullim prej të paktën 5% të kapitalit aksioner mund të kërkojë një hetim të posaçëm, duke përfshirë edhe një auditim të pasqyrave financiare të shoqërisë^{xl}.

Ligji i Auditit parashikon që auditimi të bëhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, sipas të cilave audituesi duhet të lëshojë mendimin e tij të pavarur nëse pasqyrat financiare të shoqërisë paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin e saj financiar dhe rezultatet e operacioneve dhe ndryshimeve të fluksit të parës në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit dhe standardet ndërkombëtare të raportimit financiar^{xli}.



NË BIZNESIN TUAJ

Për të respektuar Parimin 14 të Kodit të Sjelljes, administratori i shoqërisë duhet t'i bëjë vetes këto pyetje:

- A bëhen audite të brendshme dhe të jashtme në shoqërinë time?
- A u është dhënë audituesve të brendshëm dhe të jashtëm drejta që në shoqërinë time të bëjnë vlerësime të pavarura të respektimit të ligjeve kundër korrupsionit nga shoqëria ime?



TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT

Cilat do të ishin hapat e parë që do të ndërmerrnit për këtë parim? Shfrytëzoni hapësirën më poshtë për të prezantuar

idetë tuaja paraprake:



SHEMBULL: Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k. është pjesë e shoqërisë CocaCola që operon në tregun shqiptar që prej vitit 1994. Shoqëria CocaCola ka formuar një sistem kompleks për bërjen e biznesit në mënyrë të ndershme, etike dhe ligjore, përbërë nga Kodi i Sjelljes, një Politikë Kundër Mitëmarrjes dhe një program kundër korrupsionit. Pjesë e programit kundër korrupsionit janë edhe auditet periodike të njësive përkatëse të shoqërisë që e ndihmojnë shoqërinë të veprojë në përputhje me Ligjet kundër korrupsionit në fuqi dhe me programin e brendshëm kundër korrupsionit. (COCA-COLA)

PARIMI 15: GARANTIMI I RAPORTIMIT TË SHKELJEVE

Parimi 15

Shoqëria duhet t'u ofrojë udhëzime dhe këshillime gjithë drejtuesve, punonjësve, zyrtarëve për respektimin e Kodit të tyre. Ata nxiten të raportojnë çdo situatë të vështirë dhe shoqëria nuk duhet të lejojë kërcënime ndaj ndonjë punonjësi që raporton shkelje të ligjit.



NË PRAKTIKË

Për të respektuar Parimin 15 të Kodit të Sjelljes, shoqëria duhet:

- T'u ofrojë orientime dhe këshillime të gjithë drejtuesve, punonjësve, zyrtarëve, p.sh. përmes ngritjes së një departamenti të posaçëm përgjegjës/caktimit të një personi kontakti;
- T'i inkurajojë drejtuesit, punonjësit, zyrtarët që të raportojnë shkeljet e ligjit;
- Të kërkojë përshkrime të detajuara dhe prova mbështetëse në raste të shkeljes së ligjit;
- Të mbrojë çdo punonjës që raporton shkelje të ligjit nga hakmarrja, diskriminimi apo penalizimi, p.sh. përmes sigurimit të konfidencialitetit maksimal.



DISPOZITAT LIGJORE

Shqipëria ka miratuar një legjislacion modern për sinjalizuesit. Megjithatë, duhet theksuar se legjislacioni i sinjalizuesve hyn në fuqi për shoqëritë më 1 korrik 2017^{xlii}.

Çdo person, i cili vihet në dijeni për veprime ose praktika të dyshuara të korrupsionit, gjatë punës ose në lidhje me veprimtarinë e tij të punës pranë organizatës, ka të drejtë të sinjalizojë këtë fakt te njësia përgjegjëse brenda organizatës ose ILDKPKI-së, sipas rasti^{xliii}.

Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, me shkrim ose deklarohet verbalisht para ILDKPKI-së ose njësisë përgjegjëse dhe dokumentohet me shkrim prej tyre^{xliiv}. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet, nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat

e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit. Çdo autoriteti publik, i cili ka më shumë se 80 të punësuar, dhe subjekti privat, i cili ka më shumë se 100 të punësuar, caktohet një njësi përgjegjëse, e cila regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet, sipas këtij ligji^{xlv}.



NË BIZNESIN TUAJ

Për të respektuar Parimin 15 të Kodit të Sjelljes, administratori ishokërisë duhet t'i bëjë vetes këto pyetje:

- A është organizuar një trajnim në shoqërinë time për t'u dhënë udhëzime dhe këshilla të gjithë drejtuesve dhe punonjësve?
- A u lejohej të gjithë drejtuesve dhe punonjësve t'i raportojnë situatat e vështira?
- A janë marrë masa në shoqërinë time për mbrojtjen e "sinjalizuesve"?
- A u janë shpjeguar qartë të gjithë aktorëve të interesuar në shoqërinë time dispozitat ligjore në lidhje me "sinjalizuesit"?
- A garantohet konfidencialiteti në shoqërinë time?



TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT

Cilët do të ishin hapat e parë për këtë parim? Shfrytëzoheni hapësirën më poshtë për të paraqitur idetë tuaja paraprake:



SHEMBULL: Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Këmbimit (nëanglisht SEC) është organi rregullator përgjegjës për rregullimin e tregut amerikan të letrave me vlerë. Ligjet për letrat me vlerë (Ligji i Letrave me Vlerë i vitit 1933 dhe Ligji për Këmbimin e Letrave me Vlerë i vitit 1934) dhe rregullat dhe rregulloret e kësaj fushe ndalojnë mashtrimin, manipulimin dhe nxjerrjen e informacioneve

nga punonjësit e brendshëm të shoqërisë në lidhje me kontrata për sigurinë. Ligji i Letrave me Vlerë dhe Këmbimeve i vitit 1934 përmban një pjesë që mbron sinjalizuesit nga çdo hakmarrje e paligjshme nga punonjësit. Përveç kësaj, ligji parashikon të drejtën e SEC për t'u dhënë një shpërblim sinjalizuesve, që me vullnetin e tyre japin informacione origjinale në një shumë totale të barabartë me jo më pak se 10 për qind në total të asaj çka është mbledhur nga sanksionet monetare të vendosura për veprën për të cilën sinjalizohet apo vepra të tjera që lidhen me të; dhe jo më shumë se 30 për qind në total të asaj çka është mbledhur nga sanksionet monetare të vendosura për veprën për të cilën sinjalizohet apo vepra të tjera që lidhen me të. SEC u ka dhënë sinjalizuesve më shumë se \$100 milion për informacione të vlefshme që kanë dhënë për shkelje të ligjeve të letrave me vlerë.

Ligji parashikon mbrojtjen e konfidencialitetit të sinjalizuesve nga SEC.(SEC)

PARIMI 16: GARANTIMI I KOMUNIKIMIT EFIKAS

Parimi 16

Të gjithë punonjësit kanë përgjegjësinë ta lexojnë dhe ta kuptojnë këtë Kod.



NË PRAKTIKË

Për të respektuar Parimin 16 të Kodit të Sjelljes, shoqëria duhet:

- Ta shpërndajë këtë Kod;
- Të sigurojë respektimin e tij (nga të gjithë aksionerët, anëtarët e bordit, bashkëpunëtorët, si dhe nga punonjësit);
- Të garantojë caktimin e një departamenti të posaçëm/personi kontakti në rast problemesh.



NË BIZNESIN TUAJ

Për të respektuar Parimin 16 të Kodit të Sjelljes, administratori i shoqërisë duhet t'i bëjë vetes këto pyetje:

- A është shpërndarë në shoqërinë time ky Kod tek të gjithë aksionerët, drejtuesit dhe punonjësit?
- A është bërë një vlerësim i përputhshmërisë në shoqërinë time?
- A është caktuar një person kontakti/departament në rast se ka pyetje në lidhje me Kodin?



TË UDHËHEQËSH PËRMES SHEMBULLIT

Cilët do të ishin hapat e parë për këtë parim? Shfrytëzoheni hapësirën më poshtë për të paraqitur idetë tuaja paraprake:



SHEMBULL: Antea Cement sh.a., pjesë e Titan Group, është një shoqëri për prodhimin e çimentos, e cila ndodhet në Borizanë, afërsisht 50 kilometra nga Tirana. Antea Cement

është një shoqëri lider në Shqipëri që promovon praktikat etike në biznes. Kjo shoqëri vlerëson sfidat e mjedisit në të cilin operon dhe për këtë qëllim ka miratuar dhe ka vënë në jetë disa masa rregullatorë, duke përfshirë edhe një kod të sjelljes. Ky kod ndalon çdo formë korrupsioni dhe ryshfeti. Përveç kësaj, shoqëria organizon edhe trajnime për Kodin e Sjelljes për zbatimin e masave kundër korrupsionit. (ANTEA)

REFERENCAT

AGNA GROUP. (n.d.). Marrë nga <http://www.agnagroup.com/new//faqe.php?id=7&gj=en>

ANTEA. (n.d.). Marrë nga <http://www.anteacement.com/csr/csrnetwork/>

COCA-COLA. (n.d.). Marrë nga <http://www.coca-colacompany.com/our-company/governance-ethics/anti-corruption>

GlaxoSmithKline. (2016). GSK Global. Marrë nga Politikat, kodet dhe standardet: <http://www.gsk.com/en-gb/about-us/policies-codes-and-standards/#codes-of-conduct>

Hameed, S. (2014). Kostot e Korrupsionit.

ING. (2015, 12 22). ING Jobs. Marrë nga <https://www.ing.jobs/Netherlands/Recruitment-code-of-conduct-for-external-applicants.htm>

OECD, UNODOC, & WB. (2013). Manuali për Bizneset Kundër Korrupsionit, Etikës dhe Përputhshmërisë.

OSCE, & IDRA. (2015). Raportet e Pyetësorëve Kundër Mitëmarrjes për Bizneset report.

PwC. (2012). Kodi i Sjelljes. Marrë nga PwC Global: <http://www.pwc.com/gx/en/about/ethics-business-conduct/code-of-conduct.html>

RAIFFEISEN. (2017). Rreth Nesh. Marrë nga Raiffeisen Bank sh.a.: <https://www.raiffeisen.al/rreth-nesh/kodi-i-sjelljes-ne-rbal/>

SEC. (n.d.). Marrë nga <https://www.sec.gov/whistleblower>

SELDI. (2014). Raporti për Vlerësimin e Korrupsionit në Shqipëri.

SHELL. (2006). Kodi i Sjelljes së Shell-it. Marrë nga SHELL Global: <http://www.shell.com/content/dam/shell/static/public/downloads/corporate-pkg/code-of-conduct-english.pdf>

SNAM. (2013). Antikorrupsioni. Marrë nga http://www.snam.it/export/sites/snam/repository/ENG_file/Governance/Procedures/

anticorruption/SNAM-PRO-100-R00_Anticorruzione-ENG.pdf

TELEKOM. (n.d.). Pajtueshmëria. Marrë nga Telekom Albania: <https://www.telekom.com.al/kompania/pajtueshmeria/>

Republika e Shqipërisë. (2004). Marrë nga http://rai-see.org/wp-content/uploads/2015/08/Albania_Law_9284_Preventing_Striking_Organized_Crime-en.pdf

Trans Adriatic Pipeline. (n.d.). Marrë nga http://www.tap-ag.com/assets/08.about_us/english/TAP_Code_of%20Conduct_158x220_FINAL.pdf

Transparency International. (2013). PARIMET E BIZNESIT KUNDËR MITËMARRJES.

UNDP. (2015). Manual për Matjen e korrupsionit dhe antikorrupsionit.

UNODOC. (2006). Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit. Marrë nga https://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/Convention/08-50026_E.pdf

UNODOC. (2013). Biznesi, Korrupsioni dhe Krimi në Shqipëri: ndikimi i mitëmarrjes dhe krimeve të tjera tek sipërmarrjet private.

UPS. (2011). Kodi i Sjelljes së Biznesit. Marrë nga faqja e UPS-së: https://www.ups.com/media/en/code_bus_conduct.pdf

Verbund. (2017). Përputhshmëria. Marrë nga Verbund: <https://www.verbund.com/en-at/about-verbund/company/compliance>

VODAFONE. (n.d.). Marrë nga https://www.vodafone.com/content/sustainabilityreport/2014/index/operating_responsibly/ethics.html

Politikat e Vodafonit për palët e treta. (n.d.). Marrë nga http://vodafone360.com/content/index/about/about_us/suppliers/our_policies_processes_and_tools.html

WB, & IFC. (2013). Profili i Shqipërisë.

SHËNIME NË FUND TË FAQES

- i Neni 89 i Kodit Zgjedhor, i cili parashikon që shuma që çdo person fizik apo juridik mund t'i japë një subjekti zgjedhor nuk mund të jetë më e madhe sesa 1 milion lekë ose vlera e barasvlershme në natyrë ose shërbime.
- ii Neni 89 i Kodit Zgjedhor parashikon që kjo shumë të mos jetë më e madhe sesa 10 milion Lek.
- iii Neni 59 i Ligjit Nr. 9920 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"
- iv Neni 46 (2) i Ligjit Nr. 9463, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar)
- v Neni 164/a - Korrupsioni aktiv në sektorin privat dhe Neni 164/b -Korrupsioni pasiv në sektorin privat.
- vi Neni 3 i Ligjit Nr. 9754, datë 14.06.2007 "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë"
- vii Neni 26 i Ligjit Nr. 9643, datë 20 nëntor 2006 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar)
- viii Neni 13 i Ligjit Nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
- ix Neni 95 (3) i Ligjit Nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Neni 154 i Ligjit Nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
- x Neni 37 i Kodit të Punës
- xi Neni 164/a i Kodit Penal
- xii Neni 164/b i Kodit Penal
- xiii Neni 244 i Kodit Penal
- xiv Neni 244/a i Kodit Penal
- xv Neni 245 i Kodit Penal
- xvi Neni 259 i Kodit Penal
- xvii Neni 259/a i Kodit Penal
- xviii Neni 260 i Kodit Penal
- xix Neni 312 i Kodit Penal
- xx Neni 319 i Kodit Penal
- xxi Neni 319/a i Kodit Penal
- xxii Neni 319/b i Kodit Penal
- xxiii Neni 319/c i Kodit Penal
- xxiv Neni 319/ç i Kodit Penal
- xxv Neni 319/d i Kodit Penal
- xxvi Neni 319/dh i Kodit Penal
- xxvii Neni 319/e i Kodit Penal
- xxviii Neni 2(7) i Ligjit 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" (i ndryshuar)
- xxix Neni 2(8) i Ligjit 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat

	jofitimprurëse" (i ndryshuar)
xxx	Neni 35 i Ligjit 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" (i ndryshuar)
xxxi	Neni 2 i Ligjit Nr. 7892 "Për sponsorizimet" (i ndryshuar)
xxxii	Neni 4 i Ligjit Nr. 7892 "Për sponsorizimet" (i ndryshuar)
xxxiii	Neni 23 i Ligjit Nr. 9367 datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksioneve publike" (i ndryshuar)
xxxiv	Neni 89 (1) i Kodit Zgjedhor
xxxv	Neni 89 (2) i Kodit Zgjedhor
xxxvi	Neni 89 (3) i Kodit Zgjedhor
xxxvii	Neni 13 i Ligjit Nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
xxxviii	Neni 207 i Ligjit Nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
xxxix	Neni 41 i Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël te Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar" (i ndryshuar)
xl	Neni 84, 91, 139 dhe 150 i Ligjit Nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar)
xli	Neni 37 i Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël te Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar" (i ndryshuar)
xlii	Neni 25 i Ligjit Nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"
xliii	Neni 5 i Ligjit Nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"
xliv	Neni 7 i Ligjit Nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"
xlv	Neni 10 i Ligjit Nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"

